



# GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS



## Buletini Informativ

Janar – Qershor 2024



## Kushtetuta e Kosovës - Kapitulli VIII

### Gjykata Kushtetuese

#### Neni 112

[Parimet e Përgjithshme]

#### PËRMBAJTJA:

RAPORTI GJASHTËMUJOR I PUNËS .....	2
VIZITAT DHE AKTIVITETET E GJYKATËS.....	5
AKTGJYKIME .....	14
GJEDNJ - VENDIME TË RËNDËSISHME .....	32

Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe të përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën.

Gjykata Kushtetuese është plotësisht e pavarur në kryerjen e përgjegjësisë së saj.

### Përbërja e Gjykatës Kushtetuese

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës përbëhet nga 9 (nëntë) gjyqtarë.

Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës emërohen në pajtim me nenin 114 [*Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese*] të Kushtetutës, dhe të neneve 6 dhe 7 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Pas themelimit të Gjykatës Kushtetuese në vitin 2009 dhe në pajtim me nenin e mëparshëm 152 [*Përbërja e Përkohshme e Gjykatës Kushtetuese*] të Kushtetutës, 6 (gjashtë) nga 9 (nëntë) gjyqtarët u emëruan nga Presidenti i Republikës së Kosovës me propozimin e Kuvendit.

Nga 6 (gjashtë) gjyqtarët vendorë, 2 (dy) gjyqtarë shërbyen për një mandat 3 (tre) vjeçar, pa mundësi të rizgjedhjes, 2 (dy) gjyqtarë shërbyen për një mandat prej 6 (gjashtë) vjetësh, pa mundësi të rizgjedhjes, dhe 2 (dy) gjyqtarë shërbyen për një mandat prej 9 (nëntë) vjetësh, pa mundësi të rizgjedhjes.

Në pajtim me nenin e lartpërmendur 152 [*Përbërja e Përkohshme e Gjykatës Kushtetuese*] të Kushtetutës, 3 (tre) gjyqtarë ndërkombëtarë u emëruan nga Përfaqësuesi Ndërkombëtar Civil, pas konsultimit me Kryetarin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

\* Gjykata aktualisht përbëhet nga nëntë (9) gjyqtarë.








## Statusi i lëndëve

Gjatë periudhës gjashtëmuajore: 1 janar – 30 qershor 2024, Gjykata ka pranuar 137 kërkesa të reja, ndërsa ka pasur në punë gjithsej 428 kërkesa/lëndë.

Gjithsej 180 kërkesa janë zgjidhur ose 42% e të gjitha rasteve në dispozicion.

Gjatë kësaj periudhe, 142 vendime janë publikuar në ueb-faqen e Gjykatës.

*Dinamika e kërkesave të pranuar sipas muajve  
(1 janar – 30 qershor 2024)*



Në vijim janë paraqitur 11 aktgjykimet që Gjykata i nxori gjatë periudhës gjashtëmuajore, 1 janar – 30 qershor 2024:

- Aktgjykim në rastin KO79/23, parashtruar nga: Avokati i Popullit. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.
- Aktgjykim në rastin KO 55/23, parashtruar nga: Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i amendamenteve të propozuara kushtetuese, të referuara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, më 2 mars 2023, përmes shkresës nr. 8/3509/Do/1493/1.
- Aktgjykim në rastin KI 137/23, parashtruar nga: Naim Berisha. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës [Rev. nr. 451/2022], të 23 nëntorit 2022.
- Aktgjykim në rastin KI 186/22, parashtruar nga: Malush, Sejdi, Hysni, Skender, Enver, Sherif, Mehdi, Xhevat, Qemajl dhe Jakup Berisha. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës

[Rev. nr. 550/2021 ], të 6 qershorit 2022.

- Aktgjykim në rastin KI 43/23, parashtruar nga: Armend Hamiti. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës [AA. nr. 37/22], të 18 janarit 2023.
- Aktgjykim në rastin KI 103/23, parashtruar nga: Zyra e Rregullatorit për Energji e Republikës së Kosovës. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës [Arj.nr.116/2022], të 9 marsit 2023.
- Aktgjykim në rastin KI 195/22, parashtruar nga: Besim Morina. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës [AA.nr. 11/2022], të 25 gushtit 2022.
- Aktgjykim në rastin KI 168/22, parashtruar nga: Nusret Kabashi, Bajram Kabashi dhe Driton Kabashi. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës [AC-I-22-0418-A0001], të 22 shtatorit 2022.
- Aktgjykim në rastin KI 178/22, parashtruar nga: Ibrahim Tërnavë. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës [Rev. nr. 59/2021], të 6 majit 2022.
- Aktgjykim në rastin KI 38/23, parashtruar nga: Flamur Dylhas. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës [Rev. nr. 205/2022], të 10 tetorit 2022.
- Aktgjykim në rastin KI 121/22, parashtruar nga: Mexhid Asllani, Ekrem Asllani dhe Nuredin Xhaferi. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit [Rev. nr. 434/2022] të 24 majit 2022 për plotësimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës [Rev. nr. 426/2021] të 29 qershorit 2021 dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës [Ac. nr. 1148/2018], të 4 marsit 2020.



## Llojet e shkeljeve të pretenduara


Llojet e shkeljeve të pretenduara nga 137 kërkesat e pranuar gjatë periudhës gjashtëmuajore, 1 janar – 30 qershor 2024, janë si në vijim:

- Neni 2 [Sovraniteti] - 23 raste ose 7,9%;
- Neni 3 [Barazia para Ligjit] - 7 raste ose 2,4%;
- Neni 7 [Vlerat] - 6 raste ose 2,1%;
- Neni 21 [Parimet e Përgjithshme] - 5 raste ose 1,7%;
- Neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] - 2 raste ose 0,7%;
- Neni 23 [Dinjiteti i Njeriut] - 3 raste ose 1%;
- Neni 24 [Barazia para Ligjit] - 34 raste ose 11,7%;
- Neni 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] - 4 raste ose 1,4%;
- Neni 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit] - 4 raste ose 1,4%;
- Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] - 109 raste ose 37,5%;
- Neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike] - 23 raste ose 7,9%;
- Neni 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] - 2 raste ose 0,7%;
- Neni 46 [Mbrojtja e Pronës] - 20 raste ose 6,9%;
- Neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] - 12 raste ose 4,1%;
- Neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] - 9 raste ose 3,1%;
- Neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] - 26 raste ose 8,9%;
- Neni 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] - 10 raste ose 3,4%;
- Neni 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] - 8 raste ose 2,7%;
- Shkelje të tjera - 5 raste ose 1,7%.

## Autorët e supozuar të shkeljes së të drejtave

- 128 kërkesa ose 93,4% e kërkesave kanë të bëjnë me vendimet e gjykatave;
- 9 kërkesa ose 6,6% e kërkesave kanë të bëjnë me vendimet e autoriteteve të tjera publike;

Shkelësit e supozuar të të drejtave  
(1 janar – 30 qershor 2024)



## Seancat dhe kolegjet shqyrtuese


Gjatë periudhës gjashtëmuajore: 1 janar – 30 qershor 2024, Gjykata Kushtetuese ka mbajtur 28 seanca plenare dhe 190 kolegje shqyrtuese, në të cilat rastet e shqyrtuara u zgjidhën me aktgjykime, aktvendime dhe vendime.

Gjatë kësaj periudhe, Gjykata Kushtetuese ka publikuar gjithsej 142 vendime.

Struktura e vendimeve të publikuara është si në vijim:

- 11 Aktgjykime (14,2%);
- 110 Aktvendime për papranueshmëri (75,8%);
- 10 Vendime për refuzim të kërkesës me procedurë të shkurtër (7,5%);
- 2 Vendime për tërheqje të kërkesës (1,4 %);
- 1 Aktvendim për mospërmbarim (0,7%);
- 2 Vendime për hedhje poshtë të kërkesës (1,4 %);

Struktura e vendimeve të publikuara  
(1 janar – 30 qershor 2024)






## Qasja në Gjykatë

Qasja e individëve në Gjykatë është si në vijim:

- 110 kërkesa nga shqiptarët, ose 94,8%;
- 5 kërkesa nga komuniteti serb, ose 4,3%;
- 1 kërkesë nga komuniteti turk, ose 0,89%;

*Struktura etnike e parashtruesve të kërkesave  
(1 janar – 30 qershor 2024)*





**25 janar 2024**



Gjyqtarja e Gjykatës Kushtetuese, znj. Remzije Istrefi – Peci, priti në takim një grup studentësh ndërkombëtarë të Programit Evropian (EMA) për studime pasuniversitare në fushën e të drejtave të njeriut dhe demokratizim, nga kampuset universitare në Vjenë dhe Venedik. Funkzioni që ka Gjykata Kushtetuese në sistemin juridik të Republikës së Kosovës, struktura e saj organizative, palët e autorizuar për parashtrimin e kërkesave dhe roli me rëndësi që ka luajtur Gjykata ndër vite në vendosjen dhe mbrojtjen e themeleve të rendit kushtetues, ishin vetëm disa ndër temat për të cilat gjyqtarja Istrefi – Peci diskutoi në prezantimin e saj.

Gjyqtarja Istrefi – Peci në vazhdim i njoftoi studentët ndërkombëtarë edhe me kriteret e pranueshmërisë dhe trajtimin e kërkesave të parashtruara, me procesin e vendimmarrjes së Gjykatës dhe referimit të vazhdueshëm që në çdo vendim të saj i bëhet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

**16 shkurt 2024**



Gjykatën Kushtetuese e vizituan një grup studentësh nga fakulteti juridik i Universitetit Mesdhetar të Tiranës, të shoqëruar nga dekani Prof. dr. Ksenofon Krisafi dhe nga fakulteti juridik i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, të shoqëruar nga Prof. dr. Arsim Bajrami.

Studentët u pritën në takim nga kryetarja e Gjykatës Kushtetuese, znj. Gresa Caka – Nimani, e cila gjatë diskutimit të saj fillimisht i bëri një përshkrim të shkurtër historikut të hartimit të Kushtetutës dhe themelimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës,

funksionit që ka kjo gjykatë në raport me pushtetet e tjera në nivel shtetëror dhe rolin me rëndësi që ka luajtur ajo ndër vite në vendosjen dhe mbrojtjen e themeleve të rendit kushtetues në vend.

Kryetarja Caka – Nimani në vijim i informoi studentët edhe për juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, për rastet me rëndësi që ajo i ka trajtuar përkitazi me balancimin e pushteteve, si dhe në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke iu referuar në çdo vendim të saj praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Ajo i këshilloi juristët e ardhshëm që të përkushtohen sa më shumë në studimet e tyre universitare dhe në përvetësimin e njohurive profesionale, me qëllim jo vetëm të avancimit të tyre në karrierë, por edhe për zhvillimin dhe forcimin e institucioneve të drejtësisë në të dyja vendet.

**26 shkurt 2024**



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani, priti në takim Shefen e re të Misionit të USAID-it në Kosovë, znj. Eileen Devitt. Pasi që i uroi suksese znj. Devitt në detyrën e saj të re, kryetarja Caka – Nimani vuri theksin në bashkëpunimin e shkëlqyer dhe përkrahjen e çmuar që USAID i ka ofruar ndër vite Gjykatës Kushtetuese, veçanërisht në avancimin e kapaciteteve profesionale dhe infrastrukturore të saj, si dhe në përmirësimin e komunikimit me publikun. Kryetarja Caka – Nimani në vazhdim e informoi znj. Devitt më në detaje përkitazi me punën e deritanishme të Gjykatës, përbërjen aktuale të saj, praktikën e konsoliduar gjyqësore, si dhe për progresin e arritur në nivel vendi në aspektin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe zhvillimin e drejtësisë kushtetuese.

Pasi që e falënderoi kryetaren Caka – Nimani për mikpritjen, znj. Devitt shprehu mirënjohjen e saj për mundësinë e shërbimit në Kosovë dhe u zotua për vazhdimin e përkrahjes së USAID-it ndaj Gjykatës Kushtetuese dhe për institucionet e tjera në vend.





**2 mars 2024**



Një delegacion i Gjykatës Kushtetuese të Republikës Kosovës, i përbërë nga kryetarja e Gjykatës, znj. Gresa Caka – Nimani, dhe gjyqtari, z. Nexhmi Rexhepi, qëndroi për vizitë zyrtare në Riga të Letonisë, më 29 shkurt – 2 mars 2024.

Vizita e delegacionit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës u realizua me mbështetjen e Gjykatës Kushtetuese të Letonisë dhe me ftesën për të marrë pjesë në konferencën ndërkombëtare me temë: “Roli i Gjykatave Kushtetuese në konkretizimin e vlerave të përbashkëta që bashkojnë Evropën”, organizuar në shënim të 20-vjetorit të anëtarësimit të Republikës së Letonisë në Bashkimin Evropian.

Gjatë qëndrimit në Riga, krahas pjesëmarrjes në konferencën ndërkombëtare, kryetarja Caka – Nimani dhe gjyqtari Rexhepi u pritën në takim të përbashkët nga kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Letonisë, z. Aldis Laviņš.

**5 mars 2024**



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani, qëndroi për vizitë zyrtare në Madrid, më 4 – 5 mars 2024, me ftesë të

Shoqatës Botërore të Juristëve (World Jurist Association – WJA).

Kryetarja Caka – Nimani u ftua nga WJA për të marrë pjesë në konferencën ndërkombëtare të organizuar në nderim të ish-gjyqtarit të Gjykatës Supreme të Shteteve të Bashkuara, z. Anthony Kennedy, ku edhe ishte njëra ndër folëset kryesore në panelin e prezantuesve në temën: “Liria e shprehjes, demokracia dhe sundimi i ligjit”.

Shoqata Botërore e Juristëve u themelua në vitin 1963 si një forum ndërkombëtar i cili mbledh çdo vit gjyqtarët, avokatët, profesorët e së drejtës dhe figura të tjera të shquara ndërkombëtare në lëmin e drejtësisë, për të bashkëpunuar me qëllim të promovimit dhe forcimit të sundimit të ligjit në mbarë botën.

**14 mars 2024**




Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, organizuan një ligjëratë të hapur me z. Robert Spano, ish-Kryetar i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) dhe Kryetar i Bordit të Patronëve të Rrjetit Gjyqësor të Kampionëve të Çështjeve Gjimore, me temë: “Demokracia gjithëpërfshirëse dhe sundimi i ligjit – Lufta për të ardhmen tonë”.

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese, znj. Gresa Caka – Nimani dhe dekani i Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, z. Avni Puka, iu drejtuan fillimisht me fjalë rasti studentëve dhe mysafirëve tjerë të mbledhur në amfiteatrin e Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës.

Pas ligjëratës së mbajtur, z. Spano u përgjigj në disa pyetje të parashtruara nga studentët përkitazi me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përvetësimin e jurisprudencës së kësaj gjykate nga shtetet e tjera evropiane dhe rëndësinë e zbatimit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.



15 mars 2024



Mbi 100 përfaqësues të institucioneve kyçe gjyqësore, përfshirë gjykatat, prokuroritë dhe agjencitë e zbatimit të ligjit, si dhe përfaqësues të autoriteteve përkatëse qeveritare, organizatave ndërkombëtare, ambasadave dhe shoqërisë civile, u mbledhën sot në Prishtinë me rastin e konferencës “Zbatimi i Konventës së Stambollit përmes praktikës gjyqësore: Dialogu gjyqësor për një përgjigje gjyqësore efektive”.

Organizuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me Këshillin e Evropës dhe Qendrën AIRE (mbështetur nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar), ky aktivitet do të përqendrohet në diskutimin rreth zgjidhjeve praktike që do të çonin në zbatimin më të madh të Konventës së Stambollit, përmirësimin e përgjigjes gjyqësore ndaj dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional për të siguruar masa efektive dhe të koordinuara për parandalimin, hetimin dhe ndjekjen penale të këtyre krimeve.

Në hapje të konferencës, Gresa Caka-Nimani, Kryetare e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, tha se “një nga karakteristikat qendrore të Konventës së Stambollit është thirrja për veprim e përgjigje gjithëpërfshirëse dhe të koordinuar ndaj të gjitha formave të dhunës ndaj grave”, duke shtuar se konferenca e sotme do të “shërbejë si një platformë për reflektim për obligimet pozitive të Republikës së Kosovës, në kuadër të barazisë gjinore dhe parandalimit dhe luftimit efektiv të dhunës me bazë gjinore”.

“Diskutimi i hapur është mundësi e identifikimit të të arriturave, sfidave dhe zgjidhjeve. Gjithashtu, moment reflektimi për histori të trishta të grave kosovare që i janë nënshtruar dhunës së vazhdueshme në familje, përfshirë dështimet të autoriteteve shtetërore për të mbrojtur të drejtën e tyre në jetë. Kushtetuta e Republikës së Kosovës ndërthron vlerat dhe standardet më të larta në kontekst të të drejtave dhe lirive themelore, përfshirë barazinë gjinore. Jetësimi i tyre efektiv në praktikë është i mundur vetëm përmes përkushtimit të palëkundur për bashkëpunim e dialog dhe përmes avancimit të vazhdueshëm të mekanizmave që mundësojnë zbatimin e plotë të detyrimeve që burojnë nga Konventa Evropiane për të

Drejtat e Njeriut dhe Konventa e Stambollit”, tha Kryetarja Caka-Nimani.

Ndërsa, Albulena Haxhiu, Ministre e Drejtësisë dhe Koordinatore Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore, theksoi se: “Për herë të parë, institucionet e Republikës së Kosovës kanë marrë përsipër përgjegjësitë që kanë në raport me adresimin e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Në këtë rast konsideroj që për të pasur sukses në përpjekjen tonë, asnjë nga hallkat nuk duhet të dështojë përndryshe do të ballafaqohemi sërish me vrasje dhe shkeljen e të drejtave të viktimave”.

Më tutje, ajo nënvizoi se: “Duhet të bëjmë çmos që secila viktimë apo secila vajzë e grua që potencialisht mund të jetë e dhunuar në të ardhmen ta dijë që e ka mbështetjen e plotë institucionale por edhe shoqërore dhe jo e kundërta sepse kjo edhe ndihmon në raportim të dhunës dhe jo heshtje por edhe në parandalim të këtyre rasteve, gjithnjë nëse vendimet ndaj dhunuesve janë në përputhje me legjislacionin në fuqi, pra meritore”. “Edhe nga kjo Konferencë bëj thirrje që normat shoqërore që shpesh arsyetojnë dhunën, të luftohen dhe që secili institucion përgjegjës ta kryejë me profesionalizmin më të lartë, obligimin që ka, e në rast të dështimit, të merren masat të cilat jam e bindur që do të disiplinojnë në të ardhmen secilin zyrtarë pavarësisht institucionit”, tha Ministria Haxhiu.

Biljana Braithwaite, Drejtore e Programit për Ballkanin Perëndimor të Qendrës AIRE, theksoi se ndërsa vendet në rajon kanë miratuar ligje dhe standarde ndërkombëtare kundër dhunës, zbatimi joefektiv i tyre ende i lë gratë të cenueshme.

“Hulumtimi ynë tregon se ka shkelje të rënda të të drejtave të grave, të pranishme në një numër të madh të rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe femicideve në rajon. Gratë janë më së shpeshti më pak të sigurta brenda shtëpive të tyre dhe dhunuesit janë, në shumicën e rasteve, personat më të afërt me ta, p.sh., anëtarët e familjes ose partnerët e tyre. Për më tepër, çdo krizë e re sociale, ekonomike apo shëndetësore, çon në një shpërthim të ri dhune”, tha Braithwaite.

Në periudhën nga viti 2018 deri në vitin 2022 janë kryer njëzet femicide dhe katër tentativa për femicide, dhe pothuajse në të gjitha rastet viktimat janë vrarë nga bashkëshortët e tyre, thuhet në raportin “Femicidi në Republikën e Kosovës: Korniza ligjore dhe praktika gjyqësore (2018– 2022)”, prezantuar në konferencën e sotme.

Tankut Soykan, Zëvendëseshëf i Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë, theksoi se në nëntor të vitit 2022, Këshilli i Evropës publikoi një raport mbi “Vlerësimin e përafritit të ligjeve, politikave dhe masave të tjera lokale me standardet e Konventës së Stambollit”, i cili zbatoi metodologjinë e GREVIO-s. Raporti i vlerësimit përmban gjetje për çdo nen të Konventës së Stambollit dhe paraqet rekomandime dhe hapa konkretë për përafritim të mëtejshëm me Konventën e Stambollit. Raporti i vlerësimit njih progresin që është bërë, por gjithashtu identifikon fushat ku nevojitet më shumë punë dhe ku duhet të ndërmerren më shumë veprime, në disa raste edhe



urgjentisht. “Këshilli i Evropës, si organizata kryesore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në Evropë, po punon ngushtë me autoritetet lokale, përfshirë Gjykatën Kushtetuese, për të përmirësuar përgjigjet e drejtësisë ndaj dhunës ndaj grave në përputhje me standardet e Konventës së Stambollit dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut”, tha Soykan.

Në konferencë, fjalimet kryesore u mbajtën nga ekspertët ndërkombëtarë, Dunja Mijatovic, Komisionere për të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Evropës, dhe Robert Spano, ish-President i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Kryetar i Bordit të Mbrojtësve të Kampionëve Gjnor në Rrjetin Gjyqësor, ku u trajtuan strategjitë efektive për përdorimin e instrumenteve ndërkombëtare për të trajtuar dhunën ndaj grave dhe femicidin në nivel kombëtar.

**15 mars 2024**



Një delegacion i Gjykatës Kushtetuese të Republikës Kosovës, i udhëhequr nga gjyqtari i Gjykatës, z. Enver Peci, qëndroi për vizitë zyrtare njëditore në Shkup, me ftesë të Gjykatës Kushtetuese të Maqedonisë së Veriut. Delegacioni i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës u ftua për të marrë pjesë në ceremoninë e shënimit të 60-vjetorit të themelimit të Gjykatës Kushtetuese të Maqedonisë së Veriut dhe në konferencën ndërkombëtare të organizuar me këtë rast: “Mbrojtja kushtetuese-gjyqësore e lirisë së mendimit dhe lirisë së shprehjes publike të mendimeve”.

Gjyqtari Peci ishte njëri ndër prezantuesit kryesor në konferencën ndërkombëtare, i cili gjatë qëndrimit në Shkup u takua me kryetaren e Gjykatës Kushtetuese të Maqedonisë së Veriut, znj. Dobrila Kacarska dhe me homologë të tjerë nga gjykatat kushtetuese të rajonit.

**19 mars 2024**

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani, mori pjesë në konferencën e Javës së Gruas 2024, me temë:



“Udhëhiq me Gjithpërfshirje: Ndërthurja e Politikës me Ekonominë”, organizuar nga Instituti Kombëtar Demokratik (NDI) me mbështetjen e Agjencisë Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), në “Hotel Emerald” në Prishtinë.

Pjesëmarrësve në edicionin e 11-të të Java e Gruas, kryetarja Caka – Nimani iu drejtua me një prezantim në temën: “Fuqia e Veprimit: Si luftohet pabarazia gjinore përmes udhëheqësisë gjithpërfshirëse?”, ku temë diskutimi, ndër të tjera, ishte roli i Gjykatës Kushtetuese në promovimin e sundimit të ligjit, barazisë sociale, barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit.

Java e Gruas bashkon çdo vit përfaqësuesit më të lartë të institucioneve shtetërore dhe vendimmarrësit politikë, si dhe ekspertët vendor e ndërkombëtarë, për të identifikuar bashkërisht rekomandimet për përfshirje më të madhe të grave në proceset e politikëbërjes në Kosovë dhe për të promovuar një shoqëri të barabartë.

**21 mars 2024**



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani, priti në takim Ndihmës Sekretarin e Shteteve të Bashkuara për Çështje Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatim të Ligjit (INL), z. Todd D. Robinson. Pasi që e falënderoi





për vizitën, kryetarja Caka – Nimani e njoftoi z. Robinson me punën e deritanishme të Gjykatës Kushtetuese, për progresin e arritur në gjyqësinë kushtetuese dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në vend, si dhe për raportet e mira të bashkëpunimit me gjykatat homologe në rajon dhe më gjerë.

Ajo shprehu mirënjohjen e saj për kontributin e çmuar dhe mbështetjen e vazhdueshme që Qeveria e SHBA-ve i ka ofruar Republikës së Kosovës në përpjekjet e përbashkëta për konsolidimin e rendit dhe ligjit në vend. Ndihmës Sekretari i Shtetit, z. Robinson, e falënderoi kryetaren Caka – Nimani për mikpritjen dhe vuri theksin në përkushtimin e vazhdueshëm të Shteteve të Bashkuara në përkrahje të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe të punës që ajo bën në forcimin e sundimit të ligjit dhe të vlerave demokratike në Republikën e Kosovës.

**27 mars 2024**



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani, priti në takim ministren e Drejtësisë të Republikës së Austrisë, znj. Alma Zadic, e cila në takim shoqërohej nga ambasadori i Austrisë në Kosovë, z. Georg Schnetzer. Pasi që e falënderoj për vizitën, kryetarja Caka – Nimani e informoi ministren Zadic për punën e deritanishme të Gjykatës Kushtetuese, për vendimet me rëndësi dhe ndikimin që këto vendime kanë pasur në organizimin shtetëror dhe forcimin e sundimit të ligjit në vend, si dhe për zbatimin e praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në vendimmarrje.

Ajo shprehu falënderimin e saj për ndihmën e vazhdueshme që Qeveria austriake i ka ofruar Republikës së Kosovës në sektor të ndryshëm, e veçanërisht në sundimin e ligjit dhe zhvillimin demokratik, duke vënë theksin edhe në marrëdhëniet shumë të mira të bashkëpunimit me Gjykatën Kushtetuese të Austrisë dhe përkrahjen që kjo gjykatë i ka ofruar Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në përpjekjet për anëtarësim në forumet profesionale ndërkombëtare.

Ministrja Zadic shprehu mbështetjen e saj për punën e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe konfirmoi gatishmërinë e Qeverisë austriake për të vazhduar përkrahjen në të gjitha proceset nëpër të cilat po kalon aktualisht Kosova.

**29 mars 2024**



Gjyqtarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës Kosovës, znj. Remzije Istrefi – Peci, priti në takim një grup studentësh të universiteteve gjermane, ku pjesa më e madhe e tyre ishin studentë të drejtësisë.

Historiku i hartimit të Kushtetutës dhe themelimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, roli që ajo ka në hierarkinë e sistemit të drejtësisë në vend dhe obligimi kushtetues për zbatimin e jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në vendimmarrje, ishin vetëm disa ndër temat mbi të cilat gjyqtarja Istrefi – Peci u fokusua gjatë prezantimit të saj.

Ajo i bëri një përshkrim të shkurtër edhe procesit të zgjedhjes së gjyqtarëve kushtetues dhe mandatit të tyre, si dhe procedurës për parashtrimin e kërkesave dhe kohëzgjatjen e shqyrtimit të lëndëve.

Studentët gjermanë, ndër të tjera, shprehën interesimin që të informohen më për së afërmi përkitazi me strukturën dhe përbërjen aktuale të Gjykatës Kushtetuese, raportet me gjykatat e tjera homologe, si dhe për natyrën e kërkesave të parashtruara.





## 5 prill 2024



Gjyqtarët, juriskonsultja dhe këshilltarët kushtetues-juridik të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës morën pjesë në punëtori profesionale me Juriskonsulten e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), znj. Anna Austin, organizuar me mbështetjen e Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë.

Kompetencat, detyrat dhe funksioni i departamentit të Juriskonsultit brenda GJEDNJ-së, procedura për mbikëqyrjen e praktikës gjyqësore të kësaj gjykate, përgatitja e hulumtimeve rreth rasteve të parashtruara dhe raportet hulumtuese krahasimore, ishin vetëm disa ndër temat mbi të cilat znj. Austin diskutoi në sesionin e parë të punëtorisë.

Ndërsa, temë kryesore e diskutimit në sesionin e dytë ishin zhvillimi dhe përditësimi i platformave të brendshme dhe të jashtme të GJEDNJ-së për ndarjen e njohurive, udhëzuesit rreth neneve të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), udhëzuesit tematik (key-themes), baza e të dhënave mbi vendimet “Hudoc” dhe publikimi i raporteve periodike.

Sesioni i fundit i punëtorisë, që për qëllim kryesor pati përvetësimin e praktikave më të mira të GJEDNJ-së përkritazi me organizimin dhe funksionimin e departamentit të Juriskonsultit, u përmyll me shkëmbim pyetjesh dhe përgjigjesh rreth praktikës më të fundit gjyqësore të GJEDNJ-së dhe rasteve me rëndësi të publikuara gjatë vitit të kaluar.

## 8 prill 2024



Gjykatën Kushtetuese e vizituan studentët e Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, nxënësit e shkollës fillore “Besim Rexhepi” nga fshati Komogllavë i Komunës së Ferizajt dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, në aktivitetin e radhës “Dita e Gjykatës së Hapur”, të organizuar në shënim të Ditës së Kushtetutës, miratuar më 9 prill 2008.

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese, znj. Gresa Caka – Nimani, priti në takim studentët e Klinikës Ligjore të

ë Qendrës për Ndhimë Juridike Falas të Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD), e cila, ndër të tjera, i njoftoi për rëndësinë e hartimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, për historikun e së drejtës kushtetuese në vend dhe për rolin me rëndësi që luan Gjykata Kushtetuese në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke iu referuar në çdo vendim të saj praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Studentët e Fakultetit Juridik të Universitetit Prishtinës “Hasan Prishtina” dhe nxënësit e shkollës fillore “Besim Rexhepi” nga fshati Komogllavë i Komunës së Ferizajt, në takim i priti gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, z. Jeton Bytyqi. Gjatë prezantimit të tij, gjyqtari Bytyqi bëri një prezantim të shkurtër rreth historikut të themelimit të Gjykatës Kushtetuese, përbërjes aktuale dhe mandatit të gjyqtarëve kushtetues, si dhe për raportin e kësaj gjykate me gjykatat e niveleve të tjera në kuadër të sistemit gjyqësor në vend.

## 12 prill 2024



Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës e vizituan prokurorët e sapoemëruar, të gjeneratës së dhjetë, në kuadër të programit të trajnimit fillestar të organizuar nga Akademia e Drejtësisë së Kosovës.

Prokurorët e rinj u pritën në takim nga gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, z. Nexhmi Rexhepi, të cilët fillimisht i informoi me historikun e themelimit të Gjykatës dhe kompetencat e këtij institucioni, për përbërjen e gjyqtarëve kushtetues ndër vite, si dhe për procesin e përzgjedhjes së tyre. Marrëdhëniet me gjyqësorin e rregullt, procesi i parashtrimit të kërkesave dhe procedurat e trajtimit të lëndëve, si dhe zbatimi i praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në vendimmarrjen e gjyqtarëve kushtetues, ishin ndër temat tjera mbi të cilat gjyqtari Rexhepi u fokusua gjatë prezantimit të tij.

Prokurorët e rinj shprehën interesimin e tyre që të informohen më hollësisht përkritazi me pavarësinë funksionale të gjyqtarëve dhe dallimet me pavarësinë funksionale të prokurorëve, për mënyrën se si rregullohet në aspektin kushtetues dhe ligjor imuniteti i gjyqtarëve dhe i prokurorëve, si dhe për raportin e epërsisë ndërmjet Kushtetutës së vendit dhe konventave ndërkombëtare.



**16 prill 2024**



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani, priti në takim znj. Gesa Bräutigam, Ambasadore për Politikën e Jashtme Feministe dhe Drejtoreshë për të Drejtat e Njeriut në Ministrinë e Jashtme Federale të Gjermanisë.

Puna e deritanishme e Gjykatës Kushtetuese, me theks të veçantë në vendimet përkitazi me mbrojtjen e të drejtave të grave, si dhe zbatimi i praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe i Konventës së Stambollit në rastet e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, ishin disa ndër çështjet për të cilat kryetarja Caka – Nimani e njoftoi ambasadorën Bräutigam në takimin e përbashkët. Në vazhdim kryetarja Caka – Nimani diskutoi edhe për respektimin e të drejtave të grave në nivel vendi dhe për përfshirjen e tyre në institucione, veçanërisht në sistemin gjyqësor dhe në procese vendimmarrëse, për kornizën aktuale ligjore për mbrojtjen e të drejtave të grave, si dhe mekanizmat ligjor në dispozicion për kompensimin e viktimave të dhunës seksuale.

Ambasadorja Bräutigam vuri theksin nga ana e saj, në rëndësinë e respektimit të konventave ndërkombëtare përkitazi me mbrojtjen e të drejtave të grave dhe kundër dhunës seksuale.

**22 prill 2024**

Një grup studentësh të vitit të parë të Fakultetit Juridik në kuadër të Universitetit të Prizrenit

“Ukshin Hoti”, qëndruan për vizitë në Gjykatën Kushtetuese. Studentët u pritën në takim nga gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, z. Safet Hoxha.

Në prezantimin e tij para studentëve, gjyqtari Hoxha fillimisht i bëri një përshkrim të shkurtër historikut të themelimit të Gjykatës Kushtetuese, përbërjes së parë të gjyqtarëve, të kombinuar me gjyqtarë ndërkombëtarë, si dhe rolit me rëndësi që kjo gjykatë ka luajtur në zhvillimin e drejtësisë kushtetuese dhe të demokracisë institucionale në vend.

Në vazhdim, gjyqtari Hoxha i njoftoi juristët e ardhshëm edhe për palët e autorizuara sipas Kushtetutës për parashtrimin e kërkesave, për fazat e procedimit dhe shqyrtimit të lëndëve, si dhe për përfshirjen e praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në çdo vendim të Gjykatës Kushtetuese.

Studentët shprehën interesimin e tyre që të informohen në më shumë detaje përkitazi me kompetencat e Gjykatës Kushtetuese gjatë shqyrtimit të kërkesave institucionale, për procesin e zgjedhjes së gjyqtarëve kushtetues dhe për kuotën e përfaqësimit gjinor gjatë zgjedhjes së tyre.



**23 prill 2024**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës ka publikuar “Udhëzuesin Praktik mbi kriteret e pranueshmërisë: Kërkesat individuale”, i cili për qëllim ka informimin e palëve parashtruese, përfaqësuesve të palëve parashtruese dhe të komunitetit juridik në përgjithësi, për kriteret e pranueshmërisë së kërkesave individuale të parashtruara në këtë gjykatë.

Promovimi i Udhëzuesit u bë në konferencën lansuese të projektit të Këshillit të Evropës “Mbështetja për Gjykatën Kushtetuese në Zbatimin e Standardeve Evropiane për të Drejtat e Njeriut – Faza II”, që ka filluar së zbatuari nga janari i këtij viti, e cila u mbajt sot në “Hotel Venus” në Prishtinë.

Në konferencën e mbajtur, Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani, ndër të tjera theksoi se, kjo është hera e parë që publikohet një udhëzues i tillë, i cili pritet të lehtësojë dukshëm punën e avokatëve dhe





përfaqësuesve zyrtar të palëve parashtruese, gjatë parashtrimt të kërkesave individuale në Gjykatën Kushtetuese.



Përmes shtjellimit të praktikës gjyqësore të Gjykatës që ndërlihet me kriteret e pranueshmërisë së një kërkesë individuale të parashtruar sipas paragrafit 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, ky Udhëzues, mes tjerash, synon (i) t'i udhëzojë parashtruesit e kërkesave dhe/apo përfaqësuesve të tyre ligjor lidhur me përgatitjen e kërkesave; (ii) uljen e numrit të kërkesave të parashtruara në Gjykatën Kushtetuese, të cilat nuk i plotësojnë kriteret procedurale për t'u shqyrtuar në merita; dhe për rrjedhojë (iii) rritjen e numrit të kërkesave të pranueshme, të cilat mund t'i nënshtrohen vlerësimit të mëtejme në merita. Përmbajtja dhe struktura e këtij dokumenti është zhvilluar sipas shembullit të Udhëzuesit praktik për kriteret e pranueshmërisë të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), ndërkaq së shpejti do të jetë i qasshëm për të gjitha palët e interesuara edhe në ueb-faqen e Gjykatës Kushtetuese [www.gjk-ks.org](http://www.gjk-ks.org).

**3 maj 2024**



Gjyqtarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Remzije Istrefi – Peci dhe Juriskonsultja

e Gjykatës Kushtetuese, znj. Suzana Krasniqi, qëndruan për vizitë studimore në Gjykatën e Kasacionit të Republikës së Francës, me seli në Paris, më 22-26 prill 2024.

Gjatë qëndrimit në Gjykatën e Kasacionit, gjyqtarja Istrefi – Peci dhe juriskonsultja Krasniqi, u njohën më për së afërmi me proceset e brendshme të punës dhe me procedurat standarde të shqyrtimit të rasteve dhe kërkesave të parashtruara në këtë gjykatë.

Krahas gjyqtarëve dhe juristëve të angazhuar në Gjykatën e Kasacionit, gjyqtarja Istrefi – Peci dhe juriskonsultja Krasniqi u takuan edhe me z. Thomas Lyon – Caen, kryetar i Dhomës së Avokatëve pranë Këshillit të Shtetit dhe Gjykatës së Kasacionit, si dhe me gjyqtarë dhe avokatë të përgjithshëm të Dhomës Civile dhe Dhomës Penale të kësaj gjykate përkitazi me prezantimin e juridiksionit dhe kompetencave të Gjykatës së Kasacionit, përfshirë këtu pjesëmarrjen në seanca dëgjimore në këto dy Dhoma.

Një takim të veçantë ato e zhvilluan edhe me ish-gjyqtarin francez në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe anëtarin e nderit të Gjykatës së Kasacionit, z. André Potocki. Përgjatë qëndrimit në Paris, me ftesë të Universitetit të Sorbonne, gjyqtarja Remzije – Istrefi Peci gjithashtu mbajti një ligjëratë para studentëve të Fakultetit Juridik të këtij universiteti prestigjioz, në temën: “Metodat e interpretimit të Gjykatës Kushtetuese dhe ndikimi i mundshëm i së drejtës krahasuese”.

Vizita e lartcekur studimore është realizuar në vazhdimësi të bashkëpunimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës me Këshillin Kushtetues, Këshillin Shtetëror dhe Gjykatën e Kasacionit të Francës.

**25 maj 2024**



Gjyqtarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Remzije Istrefi – Peci, priti në takim një delegacion zyrtarësh të Bundestagut gjerman, i përbërë nga këshilltarë dhe staf mbështetës të deputetëve të parlamentit federal të Gjermanisë.

Përbërja e Gjykatës dhe puna e deritanishme, vendimet me rëndësi dhe referimi në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut gjatë vendimmarrjes, si dhe dispozitat kushtetuese që garantojnë mbrojtjen e të drejtave dhe



lirive themelore të njeriut në vend, ishin vetëm disa ndër temat në të cilat u fokusua gjatë bashkëbisedimit me delegacionin gjerman gjyqtarja Istrefi – Peci.

Në vazhdim të takimit ajo shprehu mirënjohjen e saj për ndihmën e ofruar ndër vite nga Qeveria gjermane në ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe infrastrukturore të Gjykatës Kushtetuese, duke veçuar themelimin e Bibliotekës së Gjykatës me përkrahjen e agjencisë gjermane për bashkëpunim ndërkombëtar “GIZ” dhe trajnimet e organizuara me gjyqësorin e rregullt nga fondacioni gjerman për bashkëpunim ligjor ndërkombëtar “IRZ”.

Nga ana e tyre, zyrtarët gjermanë shprehën interesimin që të informohen më në detaje përkitazi me vendimet më me rëndësi të Gjykatës që nga themelimi, për strukturën etnike të parashtruesve të kërkesave, për procesin e zgjedhjes së gjyqtarëve kushtetues dhe anëtarësimin e Gjykatës në organizatat dhe forumet profesionale ndërkombëtare.

Vizita në Kosovë e delegacionit të zyrtarëve të Bundestagut u organizua nga Shoqata e Evropës Juglindore, organizatë kjo e financuar nga Ministria e Jashtme Federale e Gjermanisë, në bashkëpunim me fondacionet gjermane: “Friedrich-Ebert-Stiftung”, “Friedrich-Naumann-Stiftung für die Freiheit”, “Heinrich-Böll-Stiftung”, “Konrad-Adenauer-Stiftung” dhe “Rosa-Luxemburg-Stiftung”.

#### 4 qershor 2024



Këshilltarët kushtetues-juridik të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës morën pjesë në trajnimin dy-ditor mbi të drejtën në privatësi, të organizuar me mbështetjen e Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë, më 3 dhe 4 qershor 2024, në “Hotel Sirius” në Prishtinë.

Temë kryesore në ditën e parë të trajnimit ishin e drejta e jetës private dhe familjare, koncepti i “detyrimeve negative dhe pozitive” të shtetit sipas nenit 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, çështjet dhe trendët e mbrojtjes së të dhënave në vend, si dhe mbikëqyrja e telekomunikacionit dhe komunikimit digjital në një kontekst penal.

Në ditën e dytë të trajnimit, në fokus të diskutimit ishin praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në lidhje me mbledhjen e të dhënave

(përfshirë mbikëqyrjen e fshehtë), ruajtja dhe zbulimi i tyre nga autoritetet shtetërore, standardet për mbrojtjen e të dhënave dhe qasja në informacionin personal, duke përfshirë “të dhënat shëndetësore”, si dhe përdorimi i të dhënave personale si “provë” në procedim penal. I organizuar në vazhden e trajnimeve profesionale për këshilltarë të Gjykatës Kushtetuese në kuadër të projektit të Zyrës Këshillit të Evropës në Prishtinë “Mbështetje për Gjykatën Kushtetuese në Zbatimin dhe Përhapjen e Standardeve Evropiane të të Drejtave të Njeriut”, trajnimi dyditor u mbajt me ekspertë ndërkombëtar të fushës të angazhuar me përkrahjen e Këshillit të Evropës.

#### 24 qershor 2024



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani, mori pjesë në Konferencën e 14-të të Kryetarëve të Gjykatave Supreme të Evropës Qendrore dhe Lindore, organizuar nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës në “Hotel Emerald” në Prishtinë. Në fjalën e saj hyrëse, kryetarja Caka – Nimani vuri theksin në nevojën për bashkëpunim reciprok për të adresuar sfidat brenda sistemeve gjyqësore, si dhe për ruajtjen e pavarësisë së pushtetit gjyqësor, veçanërisht në demokracitë e reja.

Ajo ndër të tjera tha se, “është absolutisht jetike që dialogu dhe bashkëpunimi gjyqësor të vë theks në nevojën për ruajtjen dhe avancimin e pavarësisë së pushtetit gjyqësor – që shfaqet e rishfaqet si sfida jo vetëm në demokracitë e reja të kësaj pjese të globit, por edhe në demokracitë më të avancuara”. Konferenca e Kryetarëve të Gjykatave Supreme të Evropës Qendrore dhe Lindore, që për synim ka promovimin e sundimit të ligjit dhe shkëmbimin e përvojave reciproke, mbledh çdo vit kryetarët e gjykatave supreme të: Republikës së Shqipërisë, Republikës së Sllovenisë, Republikës së Malit të Zi, Republikës së Bullgarisë, Republikës Çeke, Republikës së Lituaniës, Republikës së Polonisë dhe Republikës së Rumanisë.





## Aktgjykim

KO 79/23

### Parashtrues

Avokati i Popullit

#### *Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik*

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, ka vendosur lidhur me kërkesën në rastin KO 79/23, të parashtruar nga Avokati i Popullit, bazuar në përcaktimet e nënparagrafit (1) të paragrafit 2 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.

Gjykata, njëzëri, ka vendosur që të deklarojë kërkesën e pranueshme dhe të konstatojë, njëzëri, që: (i) paragrafi 2 i nenit 2 (Fushëveprimi) dhe paragrafi 2 i nenit 45 (Shfuqizimi) në ndërlidhje me paragrafin 2 të nenit 24 (Shtesa për kushte të tregut të punës), paragrafin 5 të nenit 25 (Shtesa e performancës), paragrafin 4 të nenit 28 (Shtesa për vëllimin e punës) dhe paragrafët 2 dhe 3 të nenit 42 (Përcaktimi i ekuivalencës) të Ligjit të kontestuar, nuk janë në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] dhe paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës; (ii) paragrafi 6 i nenit 6 (Paga bazë) të Ligjit të kontestuar, nuk është në përputhshmëri me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; (iii) paragrafi 2 i nenit 41 (Shtesa tranzitore) të Ligjit të kontestuar, nuk është në përputhshmëri me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit nr.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe paragrafin 1 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] dhe paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës; (iv) paragrafi 3 i nenit

41 (Shtesa tranzitore) të Ligjit të kontestuar, nuk është në përputhshmëri me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit nr.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe paragrafin 1 të nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; (v) paragrafi 4 i nenit 41 (Shtesa tranzitore) të Ligjit të kontestuar, nuk është në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 (Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit) të Protokollit nr.12 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; (vi) paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 (Shtesa tranzitore) dhe paragrafi 2 i nenit 45 (Shfuqizimi) të Ligjit të kontestuar, shpallen të pavlefshëm me hyrjen në fuqi të Aktgjykimit; (vii) në pajtim me paragrafin 1 të nenit 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës, të urdhërojë Kuvendin e Republikës së Kosovës, që brenda gjashtë (6) muajsh nga hyrja në fuqi e Aktgjykimit, të ndërmarrë veprimet e nevojshme për plotësimin dhe ndryshimin e paragrafit 2 të nenit 2 (Fushëveprimi) dhe paragrafit 6 të nenit 6 (Paga bazë) të Ligjit të kontestuar, në pajtim me Kushtetutën dhe këtë Aktgjykim; (viii) deri në plotësimin dhe ndryshimin e paragrafit 2 të nenit 2 (Fushëveprimi) të Ligjit të kontestuar, paragrafi 3 i nenit 2 (Fushëveprimi), paragrafi 2 i nenit 22 (Shtesat), paragrafi 5 i nenit 24 (Shtesa për kushte të tregut të punës), paragrafi 8 i nenit 25 (Shtesa e performancës), paragrafi 7 i nenit 28 (Shtesa për vëllimin e punës) dhe paragrafi 4 i nenit 42 (Përcaktimi i ekuivalencës), zbatohen në përputhje me Kushtetutën dhe këtë Aktgjykim; dhe (ix) ky Aktgjykim hyn në fuqi më 1 shkurt 2024.

Aktgjykimi fillimisht sqaron që Ligji i kontestuar është publikuar në Gazetën Zyrtare më 5 janar 2023, ndërsa ka hyrë në fuqi më 5 shkurt 2023. I njëjti është miratuar pasi ligji paraprak, përkatësisht Ligji nr.06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik, pas kërkesës së Avokatit të Popullit, ishte shpallur në kundërshtim me Kushtetutën përmes Aktgjykimit të Gjykatës KO219/19. Aktgjykimi, më tej, sqaron që Ligji i kontestuar, me qëllim të krijimit të një “sistemi të njëtrajtshëm të pagave në sektorin publik”, shfuqizon (i) Ligjin nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë; (ii) dispozita të caktuara të ligjeve të veçanta ndërlidhur me institucione dhe agjenci të pavarura; si dhe (iii) çdo ligj dhe akt tjetër nënligjor që është në kundërshtim me përcaktimet e tij. Sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, i njëjti përmes Shtojcave përkatëse, kategorizon të gjithë funksionarët/zyrtarët dhe nëpunësit publikë që bien në fushëveprimin e

Ligjit të kontestuar, në pozita, grupe, klasa dhe koeficientë. Efekti i këtij kategorizimi në ndërlidhje me vlerën e koeficientit të përcaktuar përmes Ligjit nr.08/L-213 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2023, ka rezultuar në ngritje substanciale të nivelit të pagave të një pjese të zyrtarëve të sektorit publik dhe zbritje substanciale të nivelit të pagave të një pjese tjetër. Kategoritë e afektuara nga zbritja e nivelit të pagave, përfitojnë nga një periudhë tranzitore dy (2) vjeçare pas hyrjes në fuqi të ligjit, përkatësisht (i) gjatë vitit të parë, njëqind përqind (100%) të shtesës tranzitore dhe rrjedhimisht, përgjatë këtij viti nuk afektohen nga zbritja e nivelit të pagës; ndërsa, (ii) gjatë vitit të dytë, pesëdhjetë përqind (50%) të shtesës tranzitore. Aktgjykimi gjithashtu sqaron që nga të drejtat e periudhës tranzitore, janë përjashtuar (i) anëtarët e shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës, të cilët për pasojë janë afektuar me zbritje të menjëhershme pagash përmes hyrjes në fuqi të Ligjit të kontestuar; dhe (ii) të gjithë personat që janë punësuar në sektorin publik pas hyrjes së tij në fuqi. Më tej, sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, Ligji i kontestuar gjithashtu (i) delegon përcaktimin e vlerës së koeficientit në një ligj tjetër, përkatësisht Ligjin për Ndarjet Buxhetore të Republikës së Kosovës; (ii) saktëson që zbritja e nivelit të pagës në Republikën e Kosovës mund të bëhet vetëm në rast të dy rrethanave përjashtimore, përkatësisht një “tronditje makroekonomike” apo shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme; (iii) saktëson rregullat e përcaktimit të kategorive të shtesave dhe kompensimeve, përfshirë tavanet/kufijtë përkatës buxhetor, duke saktësuar gjithashtu që këto çështje rregullohen ekskluzivisht me këtë ligj dhe mund të rregullohen më tej vetëm me akte të tjera nënligjore; dhe (iv) përcakton kompetencën e Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), për të miratuar, ndër tjerash, çështjet që ndërlidhen me strukturën, komponentët apo nivelet e koeficienteve në institucionet publike të Republikës së Kosovës.

Aktgjykimi gjithashtu sqaron që, Ligji i kontestuar tashmë ka prodhuar efektet e tij tek kategoritë të cilave u është ngritur niveli i pagës, si dhe tek kategoritë që u është zbritur niveli i pagës e që nuk i janë nënshtruar mbrojtjes përmes periudhës tranzitore, përkatësisht (i) për të gjithë funksionarët/zyrtarët/nëpunësit për pesëmbëdhjetë (15) vitet e para të përvojës së punës, sepse lartësia e shtesës për përvojën e punës është përgjysmuar me hyrjen në fuqi të Ligjit të kontestuar; dhe (ii) shërbimin e jashtëm të Republikës së Kosovës, i cili është përjashtuar nga e drejta në shtesë tranzitore. Me përfundimin e afatit një (1) vjeçar të periudhës/shtesës tranzitore, përkatësisht nga

5 shkurti 2024, me zbritje prej pesëdhjetë përqind (50%) të shtesës tranzitore, do të afektohen të gjithë funksionarët/zyrtarët/nëpunësit që hyjnë në fushëveprimin e Ligjit të kontestuar dhe të cilëve u është zbritur niveli i pagës sipas përcaktimeve të Ligjit të kontestuar.

Avokati i Popullit, duke u mbështetur edhe në njëqind e katër (104) ankesa të dorëzuara pranë Institucionit të tij nga funksionarë/zyrtarë/nëpunës, organizata e asociacione, me pretendime për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore si rezultat i zbritjes së nivelit të pagave në sektorin publik, në esencë, para Gjykatës pretendon që Ligji i kontestuar është nxjerrë në kundërshtim me (i) të drejtat dhe liritë themelore, përfshirë të drejtën për barazi para ligjit dhe të drejtën për gëzim paqësor të pronës; dhe (ii) ndarjen dhe balancimin e pushteteve në Republikën e Kosovës, në cenim të garancive kushtetuese për pavarësinë e institucioneve të pavarura. Avokati i Popullit, më saktësisht, pretendon që Ligji i kontestuar është në kundërshtim me parimin e sundimit të ligjit, sigurisë juridike dhe parashikueshmërisë, ndër tjerash, sepse delegon përcaktimin e vlerës së koeficientit në Ligjin për Ndarjet Buxhetore, ligj i cili është miratuar pas hyrjes në fuqi të Ligjit të kontestuar, duke rezultuar në zbritjen selektive dhe arbitrare të nivelit të pagave të një pjese të konsiderueshme të sektorit publik, në kundërshtim me përcaktimet e vet Ligjit të kontestuar, sipas të cilit, zbritja e pagave mund të jetë pasojë vetëm e një tronditjeje makroekonomike ose shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme në Republikën e Kosovës. Për më tepër, Avokati i Popullit pretendon që (i) zbritja joproporcionale e nivelit të pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve është në kundërshtim të plotë me Kushtetutën, ligjet e aplikueshme, standardet ndërkombëtare dhe Aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese; (ii) zbritja arbitrare e nivelit të pagave të shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës, si e vetmja kategori e sektorit publik të cilën Ligji i kontestuar e përjashton nga periudha dy (2) vjeçare tranzitore, është në kundërshtim me parimet e barazisë para ligjit; (iii) të gjithë të punësuarit në sektorin publik pas hyrjes në fuqi të Ligjit të kontestuar, trajtohen në mënyrë të pabarabartë përgjatë periudhës tranzitore, sepse nuk përfitojnë “pagë të njëjtë për punë të njëjtë”, në kundërshtim me vet garancitë e Ligjit të kontestuar; (iv) e drejta në gëzim paqësor të pronës të të gjithë funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve publikë deri në pesëmbëdhjetë (15) vite përvojë pune, është cenuar si rezultat i zbritjes së nivelit të shtesës për përvojë pune, pa ndjekur asnjë qëllim legjitim; (v) pavarësia funksionale, organizative dhe buxhetore e pushtetit gjyqësor dhe e institucioneve të pavarura kushtetuese,





është cenuar në kundërshtim të plotë me garancitë kushtetuese dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese; dhe (vi) Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese KO219/19, përmes të cilit, Ligji paraprak për Pagat në Sektorin Publik, është shpallur në kundërshtim me Kushtetutën dhe përmes të cilit, janë përcaktuar parimet që duhet të respektohen lidhur me pagat në sektorin publik, nuk është zbatuar nga Qeveria dhe Kuvendi. Më tej, Avokati i Popullit kërkon nga Gjykata që vlerësimin të kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar t'i nënshtrohet vetëm pjesa me efekt në zbritje të pagave dhe jo ajo në ndërlidhje me kategorinë që u janë ngritur pagat, sepse të drejtat e këtyre të fundit, nuk janë cenuar përmes Ligjit të kontestuar.

Pretendimet e Avokatit të Popullit u kundërshtuan nga Qeveria, përmes MPB-së. Kjo e fundit, sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, thekson që qëllimi i Ligjit të kontestuar është “harmonizimi i pagave në sektorin publik” dhe për më tepër, që i njëjti nuk ka prodhuar efektin e zbritjes së nivelit të pagave në sektorin publik. Kjo, sipas Ministrisë, ndër tjerash, sepse (i) vlera e koeficientit nuk është përcaktuar përmes Ligjit të kontestuar, por përmes Ligjit për Ndarjet Buxhetore, i cili nuk është kontestuar para Gjykatës; (ii) Ligji i kontestuar është i parashikueshëm sepse përcakton rrethanat në të cilat zbritja e pagës mund të bëhet në të ardhmen, ndërsa përcakton periudhë tranzicioni dy (2) vjeçare, përgjatë së cilës niveli i pagave të zbritura do të ruhet sipas përshkallëzimit të përcaktuar në të njëjtin; (iii) pavarësia e pushtetit gjyqësor nuk është cenuar sepse pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve nuk janë zbritur, por janë ngritur, duke marrë parasysh që Vendimi [nr.20/14] i Qeverisë i 20 dhjetorit 2017 dhe i cili kishte rezultuar në ngritjen e pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve, ishte nxjerrë në kundërshtim me ligjin e aplikueshëm dhe për pasojë, i njëjti është shfuqizuar nga Qeveria aktuale përmes Vendimit [nr.03/109] të 23 nëntorit 2022. Për më tepër, sipas MPB-së dhe ndër tjerash, (i) bazuar në Kushtetutë, është Qeveria ajo që propozon dhe Kuvendi që miraton buxhetin e Republikës së Kosovës; (ii) Ligji i kontestuar është në përputhje me ndarjen dhe balancimin e pushteteve dhe nuk cenon pavarësinë e institucioneve të pavarura; dhe (iii) përshkallëzimi i vlerës së shtesës së përvojës së punës është në përputhje me qëllimin e ligjvënësit për të “mbështetur dhe stimuluar kontributin si shërbim ndaj shtetit dhe shoqërisë”.

Në kontekst të fushëveprimit të vlerësimit, Aktgjykimi, fillimisht dhe ndër tjerash, thekson që (i) Kuvendi ka kompetencën e plotë kushtetuese për miratimin e ligjeve dhe përzgjedhjen e politikave që ngërthejnë të njëjtat, për aq sa ligjet e miratuara të jenë në

përputhshmëri me Kushtetutën dhe vlerat e parimet e proklamuar aty; dhe (ii) sipas praktikës së saj të konsoliduar gjyqësore, në vlerësimin e kushtetutshmërisë së akteve të kontestuara, Gjykata fokusohet vetëm në interpretimin dhe mbrojtjen e normave kushtetuese dhe jo në vlerësimin e përzgjedhjes së politikës publike që ka dërguar deri tek miratimi i një ligji të caktuar.

Në kontekstin e lartcekur dhe në vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar, Aktgjykimi, ndër tjerash, fillimisht shtjellon (i) parimet e përgjithshme lidhur me ndarjen dhe ndërveprimin e pushteteve në Republikën e Kosovës, përfshirë pavarësinë e pushtetit gjyqësor, sistemit prokurorial dhe institucioneve të pavarura kushtetuese; (ii) parimet e përgjithshme që burojnë nga praktika gjyqësore relevante e Gjykatës Kushtetuese, me theks në Aktgjykimet që, ndër vite, kanë shtjelluar në mënyrë specifike çështjet që ndërlidhen me pavarësinë funksionale, organizative dhe buxhetore të institucioneve të pavarura kushtetuese, përfshirë në kontekst të organizimit të tyre të brendshëm dhe rregullimit të specifikave lidhur me personelin e tyre; dhe (iii) parimet që janë përcaktuar përmes Aktgjykimit të Gjykatës KO219/19 lidhur me pagat në sektorin publik, përfshirë në kontekst të ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe të drejtave dhe lirive themelore. Për më tepër, Aktgjykimi gjithashtu shtjellon parimet e përgjithshme që burojnë nga praktikatat relevante ndërkombëtare, përfshirë (i) Opinionet e Komisionit të Venecias; (ii) praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) dhe të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian (GJDBE), përmes të cilave janë shqyrtuar pretendime për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore si pasojë e zbritjes së pagave/beneficioneve në sektorin publik; dhe (iii) praktikën gjyqësore të Gjykatave tjera Kushtetuese në shqyrtimin e ligjeve që ndërlidhen me pagat në sektorin publik, përfshirë por duke mos u kufizuar në Gjykatat Kushtetuese/Supreme të Bosnje dhe Hercegovinës, Kanadasë, Letonisë, Polonisë, Portugalisë, Qipros, Sllovenisë dhe Republikës së Shqipërisë.

Aktgjykimi gjithashtu rikujton faktin që përmes Aktgjykimit KO219/19, Gjykata, specifikisht, kishte tërhequr vërejtjen që bazuar në parimet kushtetuese, ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës dhe parimet relevante ndërkombëtare (i) pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve nuk mund të zbriten përgjatë ushtrimit të funksionit të tyre, përveç nëse zbritja përkatëse është bërë në mënyrë proporcionale dhe në kontekst të krizave ekonomike të njohura zyrtarisht; (ii) pavarësia funksionale, organizative dhe

buxhetore e institucioneve të pavarura kushtetuese duhet të respektohet; (iii) barra e zbritjes së pagave, nëse veç konsiderohet si e domosdoshme për shkak të krizës ekonomike, duhet të jetë proporcionale, ashtu që asnjë sektor i veçantë të mos e marrë përsipër barrën kryesore; dhe (iv) Qeveria, si propozuese e ligjeve dhe Kuvendi, si ligjvënës, gjatë hartimit të legjislacionit që ka të bëjë me pagat në sektorin publik, qoftë përmes një ligji të përgjithshëm ose përmes disa ligjeve të veçanta apo edhe amendamentimin e ligjeve ekzistuese, duhet të kenë parasysh shkallën e parashikueshmërisë, si pjesë e parimit të sigurisë juridike dhe sundimit të ligjit, përfshirë të drejtat kushtetuese për barazinë para ligjit dhe gëzimin paqësor të pronës, të të gjithë personave që mund të preken nga zbritja e mundshme e nivelit të pagave.

Marrë parasysh parimet e lartcekura dhe të shtjelluara detajisht në Aktgjykim dhe ndërlihdjen e pretendimeve dhe dispozitave të kontestuara me njëra tjetrën, vlerësimi i kushtetutshmërisë së Ligjit të lartcekur, në parim, rezulton në konstatime të Gjykatës që ndërlihdhen me dy kategori çështjesh, përkatësisht (i) sistemin e pagave dhe shpërblimeve dhe procedurave përkatëse, për aq sa afekton pavarësinë funksionale, organizative dhe buxhetore të institucioneve të pavarura kushtetuese; dhe (ii) të drejtat dhe liritë themelore në raport me zbritjen e nivelit të pagave të funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve publikë.

- *rregullat dhe kushtet për përcaktimin e nivelit të pagave që ndërlihdhen me sistemin e drejtësisë dhe institucionet e pavarura kushtetuese*

Aktgjykimi thekson që Ligji i kontestuar, ndër tjerash, saktëson edhe rregullat për përcaktimin e shtesave, kompensimeve dhe ekuivalencave, përfshirë krijimin e funksioneve, pozitive apo emërtesave të reja në institucionet publike. I njëjti, në kontekst të nëpunësve në (i) Presidencën e Republikës së Kosovës; (ii) Gjykatën Kushtetuese; (iii) Sistemin e Drejtësisë; (iv) Kuvendin e Republikës së Kosovës; dhe (v) institucionet e pavarura kushtetuese, saktëson që “zbatohet për aq sa nuk cenon pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative të garantuar me Kushtetutë”. Megjithatë, përkundër një formulimi të tillë, Ligji i kontestuar gjithashtu (i) specifikon që rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës, shtesave e kompenzimeve të të punësuarve në sektorin publik, janë ekskluzivisht objekt i rregullimit nga ky ligj dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj; ndërsa (ii) shfuqizon çdo dispozitë të ligjit apo aktit tjetër nënligjor, përfshirë dispozitat përkatëse të ligjeve të veçanta të institucioneve të pavarura dhe

aktet e tyre nënligjore, që rregullojnë çështjen e pagës, kompensimeve, shtesave, shpërblimeve apo një kategorie tjetër në fushën e pagave, e që nuk është autorizuar shprehimisht sipas dispozitave të këtij ligji. Rrjedhimisht dhe sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, përmbushja e pavarësisë funksionale, organizative dhe të administrimit të pavarur buxhetor të institucioneve të pavarura kushtetuese, është kushtëzuar vetëm në nxjerrjen e akteve nënligjore nën kufizimet specifike të Ligjit të kontestuar. Një qasje e tillë nuk është ndjekur në kontekst të institucioneve të pavarura përmes Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, i cili i është nënshtruar kontrollit të kushtetutshmërisë përmes Aktgjykimit të Gjykatës KO216/22\_dhe KO220/22, ligj ky që institucioneve të lartcekura, u njeh të drejtën e ushtrimit të funksioneve përkatëse edhe me ligje të veçanta. Sipas sqarimeve të dhëna, një përcaktim i tillë i Ligjit të kontestuar, kushtëzon dhe cenon pavarësinë e institucioneve të pavarura, me theks në dy kategori çështjesh, përkatësisht lidhur me (i) përcaktimin e nivelit të shtesave mbi pagën bazë; dhe (ii) përcaktimin e ekuivalencave.

Në kontekst të çështjes së parë, përkatësisht kushteve dhe tavaneve buxhetore për përcaktimin e shtesave, Aktgjykimi sqaron që sipas Ligjit të kontestuar, lartësia e shtesave, në parim, përcaktohet në vlerën prej zero pikë një përqind (0.1%) deri në zero pikë pesë përqind (0.5%) të fondeve totale të përdorura për pagën bazë të zyrtarëve publikë të organizatës përkatëse buxhetore në të njëjtin vit fiskal, ndërsa për këtë qëllim, Qeveria trajtohet si një (1) organizatë e vetme buxhetore. Përtej konstatimit që, kushtëzimi i institucioneve të pavarura që të përmbushin pavarësinë e tyre kushtetuese vetëm përmes nxjerrjes së akteve nënligjore nën rrethanat e kushtëzuara përmes Ligjit të kontestuar, cenon pavarësinë e tyre organizative dhe buxhetore, Aktgjykimi, ndër tjerash, vë theks edhe në tri çështje, përkatësisht (i) që përmbushja e qëllimit të normave që përcaktojnë tavane buxhetore në shtesa, ndërlihdhet me tërësinë e fondeve për pagën bazë me të cilat disponon institucioni përkatës dhe në kontekst të përcaktimit që Qeveria do të trajtohet si një (1) organizatë e vetme buxhetore dhe marrë parasysh që fondet e tërësishme që e njëjta i disponon janë pakrahasimisht më të larta sesa ato të institucioneve të pavarura kushtetuese, Qeveria vihet në pozitë më të favorshme krahasuar me institucionet tjera; (ii) për më tepër, më pak se dy (2) muaj pas hyrjes në fuqi të Ligjit të kontestuar, përmes Ligjit nr.08/L-213 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.08/L-193 për Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2023, i është mundësuar Qeverisë që të tejkalojë tavanet buxhetore



të shtesave të përcaktuara përmes Ligjit të kontestuar, me vendim të Ministrit, duke përjashtuar rrjedhimisht, të paktën Qeverinë nga kufizimet e Ligjit të kontestuar; dhe (iii) për deputetët e Kuvendit dhe/ose anëtarët e kuvendeve komunale, përmes Ligjit të kontestuar, është përcaktuar vlera prej tridhjetë përqind (30%) të shtesave mbi pagën përkatëse bazë. Një qasje e tillë, përmes të cilës, në esencë, pushtetet dhe institucionet e pavarura kushtetuese janë të vetmet që i nënshtrohen kufizimeve, përkatësisht tavaneve buxhetore në kontekst të shtesave, nuk është në përputhje me garancinë kushtetuese për pavarësinë institucionale të tyre dhe me ekuilibrin e ndërveprimit ndër-pushtetesh.

Ndërsa, në kontekst të çështjes së dytë, përkatësisht përcaktimit të ekuivalencave, Aktgjykimi sqaron që Ligji i kontestuar ndalon çdo ndryshim në strukturën, komponentët apo nivelet e koeficientëve të pagave dhe çdo krijim të funksioneve, pozitave apo emërtesave të reja e kushtëzon me miratimin e Qeverisë, përkatësisht MPB-së. Një përcaktim i tillë ligjor, përmes të cilit, çështjet që ndërlidhen me pavarësinë funksionale dhe të organizimit të brendshëm të institucioneve të pavarura kushtetuese, duhet t'i nënshtrohet miratimit të Qeverisë, tashmë është shpallur në kundërshtim me Kushtetutën, në një numër aktgjykimesh të Gjykatës, përfshirë (i) KO73/16 lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Qarkores Administrative nr.01/2016 të nxjerrë nga Ministria e Administratës Publike; (ii) KO171/18 lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; (iii) KO203/19 lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë të Ligjit nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë; (iv) KO219/19 lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr.06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik; dhe së fundi, (v) KO216/22 dhe KO220/22 lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë.

Aktgjykimi, më tej, sqaron që (i) të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës i nënshtrohen detyrimit të zbatimit të ligjeve relevante përkitazi me menaxhimin e financave publike, procedurave të auditimit të brendshëm sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe kontrollit të Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës bazuar në përcaktimet e neneve 136 [Auditori i Përgjithshëm i Kosovës] dhe 137 [Kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës] të Kushtetutës; dhe (ii) rikujton që Gjykata në mënyrë të vazhdueshme ka theksuar që pavarësia kushtetuese e institucioneve të pavarura kushtetuese nuk duhet të nënkuptohet si autorizim kushtetues për të vepruar në izolim nga

pushtetet e tjera të përcaktuara me Kushtetutë. Aktgjykimi, megjithatë thekson që në ushtrimin e këtyre detyrave publike, përfshihet edhe obligimi i secilit pushtet që të përkujdeset për respektim të pavarësisë së pushtetit, tek i cili po krijon një “ndërhyrje” në dëm të ekuilibrit kushtetues. Në mbrojtje të këtij parimi, Gjykata ka theksuar në vazhdimësi që, Qeveria dhe Kuvendi, në ushtrimin e kompetencës për të propozuar dhe votuar ligje, duhet të sigurohen që të ruajnë pavarësinë kushtetuese të pushtetit gjyqësor dhe institucioneve tjera shtetërore të cilat Kushtetuta i ka mveshur me garanci kushtetuese të pavarësisë “funksionale, organizative dhe buxhetore”. Ligji i kontestuar, në kundërshtim me pavarësinë kushtetuese të institucioneve të pavarura dhe praktikën gjyqësore konsistente të Gjykatës Kushtetuese, nuk respekton këtë parim. Për pasojë, Gjykata ka konstatuar që paragrafi 2 i nenit 2 (Fushëveprimi) dhe paragrafi 2 i nenit 45 (Shfuqizimi) në ndërlidhje me paragrafin 2 të nenit 24 (Shtesa për kushte të tregut të punës), paragrafin 5 të nenit 25 (Shtesa e performancës), paragrafin 4 të nenit 28 (Shtesa për vëllimin e punës) dhe paragrafët 2 dhe 3 të nenit 42 (Përcaktimi i ekuivalencës) të Ligjit të kontestuar, nuk janë në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] dhe paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës.

- *të drejtat dhe liritë themelore në raport me zbritjen e nivelit të pagës të funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve publikë*

Në vlerësimin nëse zbritja e nivelit të pagave në sektorin publik, ka cenuar të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë, Aktgjykimi, fillimisht shtjellon praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së në kontekst të vlerësimit të cenimit të të drejtave si rezultat i zbritjes së pagave/beneficioneve sociale përgjatë krizave ekonomike dhe sipas të cilës, rezulton që pagat/beneficionet sociale që burojnë, ndër tjerash, nga një e drejtë konkrete në ligjet e aplikueshme, përbëjnë një “pasuri” të ndërlidhur me “pritje legjitime” dhe rrjedhimisht, konsiderohet që gjenerojnë një interes pronësor që bie në fushëveprimin e nenit 1 (Mbrojta e pronës) të Protokollit nr.1 të KEDNJ-së. Për pasojë dhe më tej, duke aplikuar parimet që burojnë nga praktika e lartcekur gjyqësore, Aktgjykimi sqaron që nuk është kontestuese që zbritja e nivelit të pagave në sektorin publik ka rezultuar në “ndërhyrje/kufizim” të së drejtës në gëzim paqësor të pronës dhe që një “ndërhyrje/kufizim” i tillë, është i “përcaktuar me ligj” dhe ndjek “një qëllim legjitim”, përkatësisht atë të “njëtrajtshmërisë” së pagave në sektorin publik.



Megjithatë, Aktgjykimi sqaron që në rastet që ka shqyrtuar GJEDNJ në lidhje me zbritjen e pagave/beneficioneve sociale, zbritja përkatëse nuk ishte rezultat i një qëllimi të tillë legjitim, por pasojë e krizave ekonomike dhe/ose masave të ndërmarra për të adresuar deficitet buxhetore. Thënë këtë, Aktgjykimi më tej fokusohet në vlerësimin nëse “ndërhyrja/kufizimi” në të drejtat dhe liritë themelore është “proporcional” me qëllimin e ndjekur, dhe nëse ka një “ekuilibër të drejtë” në mes të interesit të përgjithshëm dhe detyrimit për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të subjekteve të afektuara, të cilët nuk duhet të bartin barrë proporcionalisht më të madhe në realizimin e këtij qëllimi. Në këtë vlerësim, Aktgjykimi fokusohet në pesë (5) kategori funksionarësh/zyrtarësh/nëpunësish që janë afektuar përmes Ligjit të kontestuar, përkatësisht (a) gjyqtarët dhe prokurorët; (b) funksionarët/zyrtarët/nëpunësit tjerë të cilët janë afektuar nga zbritja e nivelit të pagës; (c) shërbimi i jashtëm i Republikës së Kosovës; (d) funksionarët/zyrtarët/nëpunësit që janë punësuar pas hyrjes në fuqi të Ligjit të kontestuar; dhe (e) të gjithë të punësuarit në sektorin publik për pesëmbëdhjetë (15) vitet e para të përvojës së punës në kontekst të përgjysmimit të lartësisë së shtesës për përvojën e punës përmes Ligjit të kontestuar.

#### *(a) gjyqtarët dhe prokurorët*

Aktgjykimi, ndër tjerash, thekson që standardet kushtetuese dhe ndërkombëtare në kontekst të pavarësisë së sistemit të drejtësisë, tashmë janë shtjelluar, ndër vite, përmes praktikës gjyqësore të Gjykatës. Aktgjykimi, më tej, sqaron që (i) përkitazi me nivelin e pagës së gjyqtarëve dhe prokurorëve, ka garanci që burojnë nga instrumente ndërkombëtare dhe kushtetuese e ligjore në Republikën e Kosovës; (ii) ligjet e aplikueshme të Republikës së Kosovës, përkatësisht Ligji për Gjykatat dhe Ligji për Prokurorin e Shtetit, garantojnë mbajtjen e nivelit të njëjtë të pagës gjatë mandatit të një gjyqtari dhe/ose prokurori, dispozita këto të cilat Ligji i kontestuar i shfuqizon; (iii) gjyqtarët dhe prokurorët e Republikës së Kosovës, janë kategoria e cila është afektuar më së shumti përmes Ligjit të kontestuar, përkatësisht deri në pesëdhjetë përqind (50%) zbritje në vlerës të pagës; dhe (iv) bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, GJDBE-së dhe Aktgjykimeve të Gjykatave tjera Kushtetuese, të vetmet raste kur gjykatat e lartcekura nuk kanë konstatuar shkelje në kontekst të zbritjes së nivelit të pagave të pushtetit gjyqësor, janë rrethanat e krizave ekonomike/financiare, përgjatë të cilave janë ndërmarrë masa gjithëpërfshirëse për stabilizimin e ekonomisë, duke rezultuar në zbritje të përkohshme dhe të përshkallëzuar të pagave të të gjithë zyrtarëve

publikë, duke vendosur mbi gjyqtarët dhe prokurorët barrë të barabartë sikurse mbi zyrtarët e tjerë. Në rrethanat e Ligjit të kontestuar, ky dukshëm nuk është rasti. Për më tepër, sipas shtjellimeve në Aktgjykim, ngritja e pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve përmes Vendimit [nr.20/14] të 20 dhjetorit 2017 të Qeverisë, është shqyrtuar përmes Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KO12/18, i cili ka bërë vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të lartcekur. Sipas sqarimeve të dhëna, zbritja joproporcionale e nivelit të pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Kosovës, nuk ngërthen vetëm çështje që ndërlidhen me cenimin e të drejtave dhe lirive individuale të gjyqtarëve dhe prokurorëve, por edhe çështje serioze të cenimit të pavarësisë së pushtetit gjyqësor, ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe ekuilibrit kushtetues e vlerave të rendit kushtetues të Republikës së Kosovës. Për pasojë, Gjykata ka konstatuar që paragrafi 2 i nenit 41 (Shtesa tranzitore) të Ligjit të kontestuar, nuk është në përputhshmëri me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit nr.1 të KEDNJ-së dhe paragrafin 1 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] dhe paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës.

- *kategoritë tjera të funksionarëve, zyrtarëve dhe nëpunësve që afektohen me zbritje të nivelit të pagave përmes Ligjit të kontestuar*

Aktgjykimi rikujton që në Aktgjykimin e saj paraprak që ndërlidhet me pagat në sektorin publik, përkatësisht Aktgjykimin KO219/19, veçanërisht kishte theksuar që (i) përderisa qëndrueshmëria e financave publike është me interes për të gjithë, arritja e këtij qëllimi duhet të aplikohet në mënyrë universale, përkatësisht barra duhet shpërndarë në mënyrë të barabartë midis të gjithë zyrtarëve; dhe (ii) barra e uljes së pagave, nëse veç konsiderohet si e domosdoshme për shkak të krizës ekonomike, duhet të jetë proporcionale dhe të përfshijë të gjithë në mënyrë të barabartë, ashtu që asnjë sektor i veçantë të mos e marrë përsipër barrën kryesore. Një qëndrim i tillë është i mbështetur edhe nga standardet ndërkombëtare, përfshirë praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së. Kjo e fundit, reflekton disa karakteristika të përbashkëta, përkatësisht që (i) zbritjet e pagave/beneficioneve dhe/ose përcaktimet/ngritjet e taksave ndërlidheshin me vendosjen e masave gjithëpërfshirëse për të adresuar krizat ekonomike dhe/ose deficitet buxhetore në shtetet përkatëse; (ii) zbritjet ishin gjithnjë të përkohshme, me raste duke përfshirë edhe mekanizma përmes të cilave nivelet e pagave gradualisht ktheheshin në nivelin paraprak; dhe (iii) ishin aplikuar në mënyrë të njëtrajtshme



përgjatë administratës shtetërore. Aktgjykimi sqaron që Ligji i kontestuar, dallon në mënyrë thelbësore nga rrethanat e lartcekura, ndër tjerash, sepse zbritja selektive e nivelit të pagave në sektorin publik (i) nuk ndërlidhet në asnjë rrethanë me krizë ekonomike, deficit buxhetor ose rrethana të jashtëzakonshme; (ii) nuk është e përkohshme e as e njëtrajtshme; (iii) ka ngritur nivelin e pagave të një kategorie të funksionarëve/zyrtarëve dhe nëpunësve në mënyrë substanciale, ndërsa ka afektuar me zbritje po aq substanciale disa nga kategoritë tjera, përfshirë duke përjashtuar kategori të tëra nga të drejtat e periudhës tranzitore. Sipas sqarimeve të dhëna, mekanizmi i zgjedhur nga ligjvënësi për të realizuar qëllimin e Ligjit të kontestuar, nuk përmbushë detyrimet që burojnë nga neni 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] i Kushtetutës, sipas të cilit, në kufizimin e të drejtave dhe lirive themelore, institucionet publike janë të detyruara të vlerësojnë raportin midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël. Duke vënë barrë joproporcionale vetëm në disa kategori të sektorit publik, nuk është arritur një “ekuilibër i drejtë” në mes interesit të përgjithshëm dhe detyrimit për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore, me pasojën e cenimit të të drejtave për gëzim paqësor të pronës në mënyrë plotësisht joproporcionale. Për pasojë, Gjykata ka konstatuar që paragrafët 2 dhe 3 të nenit 41 (Shtesa tranzitore) të Ligjit të kontestuar, nuk janë në përputhshmëri me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit nr.1 të KEDNJ-së.

*(c) shërbimi i jashtëm i Republikës së Kosovës*

Aktgjykimi, në vijim, sqaron që shërbimi i jashtëm i Republikës së Kosovës është proporcionalisht ndër më të afektuarit nga zbritja e nivelit të pagës, së bashku me kategorinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve, por për dallim nga këta të fundit, gjithashtu është përjashtuar edhe nga e drejta në shtesën tranzitore dhe rrjedhimisht është afektuar me zbritje të menjëhershme të nivelit të pagës përmes hyrjes në fuqi të Ligjit të kontestuar. Për pasojë, dhe sipas shtjellimeve të dhëna në Aktgjykim, përtej cenimit joproporcional të së drejtës në gëzim paqësor të pronës, kategoria e shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës, ngritë edhe çështje që ndërlidhen me barazinë para ligjit. Në kontekst të kësaj të fundit, Aktgjykimi shtjellon parimet që burojnë nga neni 24 [Barazia para Ligjit] i Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) dhe nenin 1 (Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit) të Protokollit nr.12 të KEDNJ-së dhe në aplikimin e kriterëve

përkatese për të konstatuar nëse “dallimi në trajtim” rezulton në shkelje të dispozitave të lartcekura, Gjykata ka konstatuar që ky është rasti përkitazi me kategorinë e shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës. Për pasojë, Gjykata ka konstatuar që paragrafi 3 i nenit 41 (Shtesa tranzitore) të Ligjit të kontestuar, nuk është në përputhshmëri me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit nr.1 të KEDNJ-së dhe me paragrafin 1 të nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) të KEDNJ-së.

- *kategoria e funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve që punësohen pas hyrjes në fuqi të Ligjit të kontestuar*

Aktgjykimi, gjithashtu sqaron që sipas Ligjit të kontestuar, çdo person që punësohet pas miratimit të tij, përfiton pagën sipas Shtojcave përkatëse të Ligjit dhe nuk gëzon të drejtën e shtesës tranzitore. Për pasojë, një pjesë e kësaj kategorie, kompensohet me pagë më të ulët dhe të ndryshme për punë të barabartë në kontekst të pozitive ekuivalente, për një periudhë dy (2) vjeçare, përkatësisht për aq sa zgjatë periudha tranzitore. Aktgjykimi tutje sqaron, që kjo kategori e cila është punësuar pas hyrjes në fuqi të Ligjit të kontestuar, nuk i nënshtrohet garancive që ndërlidhen me të drejtën në gëzim paqësor të pronës në kontekst të fushëveprimit të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit nr.1 të KEDNJ-së. Thënë këtë, e njëjta ngritë çështje që ndërlidhen me parimet e barazisë para ligjit të garantuara përmes nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, sepse një pjesë e funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve që hyjnë në fushëveprimin e këtij ligji, por që janë punësuar pas hyrjes në fuqi të të njëjtit, nuk do të kenë pagë të njëjtë dhe/ose të barabartë me kolegët e tyre që janë punësuar para hyrjes në fuqi të Ligjit të kontestuar, në kundërshtim edhe me vet garancitë që ngërthen Ligji i kontestuar. Sipas shtjellimeve të dhëna në Aktgjykim, dhe në aplikimin e kriterëve përkatëse që ndërlidhen me të drejtat për barazi para ligjit, Gjykata ka konstatuar që “dallimi në trajtim” në mes këtyre dy kategorive, nuk është proporcional me qëllimin e ndjekur dhe rrjedhimisht, rezulton në cenimin e të drejtave për barazi para ligjit të kësaj kategorie funksionarësh/zyrtarësh dhe nëpunësish. Për pasojë, Gjykata ka konstatuar që paragrafi 4 i nenit 41 (Shtesa tranzitore) të Ligjit të kontestuar, nuk është në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 (Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit) të Protokollit

nr.12 të KEDNJ-së.

- *përgjysmimi i lartësisë së shtesës për përvojën e punës përgjatë pesëmbëdhjetë (15) viteve të para të përvojës së punës*

Aktgjykimi gjithashtu sqaron që Ligji i kontestuar e përgjysmon lartësinë e shtesës për përvojën e punës, nga zero pikë pesë përqind (0.5%) në zero pikë njëzetë e pesë përqind (0.25%), për çdo vit të plotë pune përgjatë pesëmbëdhjetë (15) viteve të para të përvojës së punës, duke afektuar lartësinë e pagës për të gjithë funksionarët/zyrtarët/nëpunësit që hyjnë në fushëveprimin e Ligjit të kontestuar. Sipas shtjellimeve në Aktgjykim, nuk është kontestuese që e drejta e shtesës në pagën bazë prej zero pikë pesë përqind (0.5%) për çdo vit të përvojës së punës buron nga neni 18 (Shtesa mbi pagën për përvojën e punës) i ligjit paraprak, përkatësisht, Ligjit nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe rrjedhimisht, “ndërrhyrja” në këtë të drejtë përmes Ligjit të kontestuar, i nënshtrohet kontrollit të garancive të përcaktuara përmes nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr.1 të KEDNJ-së. Aktgjykimi, duke aplikuar praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së sqaron që, përderisa nuk është kontestuese që “ndërrhyrja” përkatëse në të drejtën për gëzim paqësor të pronës është “e përcaktuar” përmes Ligjit të kontestuar, e njëjta nuk ndjek asnjë “qëllim legjitim”. Kjo, ndër tjerash, sepse përgjysmimi i nivelit të lartësisë së shtesës për pesëmbëdhjetë (15) vitet e para të përvojës së punës, (i) nuk është bërë as për qëllime të krizës ekonomike apo të një situatë të jashtëzakonshme, dhe (ii) as për qëllime të “njëtrajtshmërisë së sistemit të pagave në sektorin publik” që reflekton qëllimin e Ligjit të kontestuar, por (iii) sipas MPB-së, është bërë për të “mbështetur dhe stimuluar kontributin si shërbim ndaj shtetit dhe shoqërisë”. Sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, një qëllim i tillë, nuk reflekton detyrimet që burojnë nga neni 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] i Kushtetutës, sipas të cilit, kufizimi i të drejtave dhe lirive themelore, nuk mund të bëhen për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat janë përcaktuar, për më tepër që, nuk reflekton as detyrimin e autoritetit publik që të balancojë kufizimin dhe qëllimin që synohet të arrihet, duke shqyrtuar mundësinë e realizimit të qëllimit me kufizim më të vogël. Për pasojë, Gjykata ka konstatuar që paragrafi 6 i nenit 6 (Paga bazë) të Ligjit të kontestuar, nuk është në përputhshmëri me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr.1 të KEDNJ-së.

- *efektet e konstatimeve të Gjykatës*

Në fund dhe në kontekst të efekteve të Aktgjykimit që ndërlidhen me konstatimet e Gjykatës përkitazi me mospërputhshmërinë me Kushtetutën të dispozitave të lartcekura të Ligjit të kontestuar, duke u bazuar në parimet që burojnë nga Opinionet relevante të Komisionit të Venecias, praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, me theks në balancimin në mes të parimit të sigurisë juridike dhe të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë, Aktgjykimi sqaron katër (4) kategoritë kryesore të efekteve të tij, si në vijim:

**Së pari**, konstatimet e Aktgjykimit, nuk afektojnë në asnjë mënyrë kategorinë e funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve të cilëve u është ngritur niveli i pagës përmes Ligjit të kontestuar.

**Së dyti**, shpallja në kundërshtim me Kushtetutën dhe për pasojë shfuqizimi i paragrafëve 2 dhe 3 të nenit 41 (Shtesat tranzitore) të Ligjit të kontestuar, ka pasojën e ruajtjes së nivelit ekzistues të pagave në sektorin publik derisa paga e re, përkatësisht ajo e përcaktuar përmes Ligjit të kontestuar, të bëhet e barasvlershme me pagën ekzistuese. Një përcaktim i tillë buron nga paragrafi 1 i nenit 41 (Shtesat tranzitore) të Ligjit të kontestuar, sipas të cilit, nëse një zyrtar publik apo funksionar publik, para hyrjes në fuqi të këtij ligji përfitonte pagë që është më e madhe se paga e plotë e parashikuar me këtë ligj, ajo/ai do të përfitojë pagën e re sipas dispozitave të këtij ligji dhe shtesën tranzitore të barabartë me diferencën ndërmjet pagës aktuale dhe pagës së re bazë. Rritja e vlerës së koeficientit për çdo vit fiskal në raport me zvogëlimin proporcional të shtesës tranzitore, duke e ruajtur nivelin e pagës ekzistuese për kategoritë që kanë pësuar zbritje pagash, gradualisht rezulton në “harmonizimin/nivelizimin” e plotë me nivelin e pagës së re, të cilën e saktëson Ligji i kontestuar përmes Shtojcave përkatëse. Për më tepër, shpallja në kundërshtim me Kushtetutën dhe shfuqizimi i paragrafit 3 të nenit 41 (Shtesat tranzitore) të Ligjit të kontestuar, në kontekst të kategorisë së shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës, nga hyrja në fuqi e Aktgjykimit, ndërthen detyrimin e trajtimit të kësaj kategorie sipas përcaktimeve të paragrafit 1 të nenit 41 (Shtesat tranzitore) të Ligjit të kontestuar.

**Së treti**, shpallja në kundërshtim me Kushtetutën dhe për pasojë, shfuqizimi i paragrafit 4 të nenit 41 (Shtesat tranzitore) të Ligjit të kontestuar, ndërthen detyrimin e nivelizimit të pagave, nga hyrja në fuqi e Aktgjykimit, të kategorisë të të punësuarve pas hyrjes në fuqi të ligjit të lartcekur, bazuar në vet nenin 4 (Parimet e sistemit të pagave) të tij, sipas të cilit, ndër



tjerash, “secili, pa kurrfarë diskriminimi, ka të drejtë që për punë të barabartë të marrë pagë të barabartë”.

**Së katërti**, përkundër faktit që (i) paragrafi 6 i nenit 6 (Paga bazë) të Ligjit të kontestuar e që ndërlidhet me lartësinë e shtesës për përvojë të punës; dhe (ii) paragrafi 2 i nenit 2 (Fushëveprimi) i Ligjit të kontestuar ndërlidhur me dispozitat e saktësuara në dispozitivin e Aktgjykimit, janë vlerësuar në kundërshtim me Kushtetutën, Gjykata nuk ka shfuqizuar të njëjtat, sepse (i) shfuqizimi i të parës ndërlidhur me faktin që Ligji i kontestuar gjithashtu shfuqizon Ligjin nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, do të rezultonte në zbrazëti ligjore përkitazi me të drejtën për shtesa mbi pagën për përvojën e punës; ndërsa (ii) shfuqizimi i të dytës, do të afektonte zbatimin e Ligjit të kontestuar në tërësinë e tij. Për pasojë, bazuar në nenin 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës, Gjykata ka urdhëruar Kuvendin që në periudhën prej gjashtë (6) muajsh pas hyrjes në fuqi të këtij Aktgjykimi, të ndryshojë dhe/ose plotësojë nenet e lartcekura në pajtim me Kushtetutën dhe Aktgjykimin e Gjykatës, me sqarimin që në kontekst të (i) paragrafit 6 të nenit 6 (Paga bazë) të Ligjit të kontestuar, të drejtat që ndërlidhen me shtesën në përvojën e punës duhet të saktësohen përmes ndryshimit/plotësimit të Ligjit të kontestuar nga Kuvendi, por me efekt nga hyrja në fuqi e këtij Aktgjykimi; ndërsa (ii) paragrafit 2 të nenit 2 (Fushëveprimi) të Ligjit të kontestuar, pavarësia funksionale, organizative dhe buxhetore e institucioneve të pavarura kushtetuese, interpretohet dhe zbatohet në përputhje me Kushtetutën dhe Aktgjykimin e Gjykatës. Kjo e fundit, marrë parasysh përgatitjet e nevojshme për zbatimin e këtij Aktgjykimi, ka përcaktuar që Aktgjykimi hyn në fuqi më 1 shkurt 2024.



## Aktgjykim

KO 55/23

### Parashtrues

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës

*Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së amendamenteve të propozuara kushtetuese, të referuara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 2 mars 2023, përmes shkresës nr. 8/3509/Do/1493/1*

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës ka vendosur në rastin KO55/23, përkitazi me kërkesën për vlerësimin e kushtetutshmërisë së amendamenteve të propozuara kushtetuese nga dyzet (40) deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të referuara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, më 2 mars 2023, përmes shkresës nr.08/3509/Do/1493/1. Kërkesa është dorëzuar në Gjykatë bazuar në paragrafin 9 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] dhe paragrafit 3 të nenit 144 [Amendamenti] të Kushtetutës, sipas të cilit, Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, para miratimit në Kuvend, duhet të referojë amendamentet e propozuara kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese, me qëllim që të konstatohet nëse amendamentet e propozuara i pakësojnë të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] të Kushtetutës. Gjykata, njëzëri, ka vendosur që të deklarojë kërkesën e pranueshme, dhe ka konstatuar: (i) me gjashtë (6) vota për dhe dy (2) vota kundër, që amendamenti i propozuar kushtetues nr.29, përmes të cilit propozohet kontrolli kalimtar/i përkohshëm i integritetit të “[...]anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, anëtarëve të Këshillit Prokurorial të Kosovës, kryetarëve të të gjitha gjykatave dhe të gjithë kryeprokurore, si dhe kandidatëve për këto pozita[...]”, nga Autoriteti për Kontrollin e Integritetit (Autoriteti), nuk pakëson të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës; (ii) njëzëri, që amendamentet e



propozuara kushtetuese nr.27 dhe nr.28, përmes të cilave propozohet plotësimi i kriterit kushtetues për shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve për shkak të “mosrespektimit të rëndë të detyrave”, i përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 104 [Emërimi dhe Shkarkimi i Gjyqtarëve] dhe paragrafin 6 të nenit 109 [Prokurori i Shtetit] të Kushtetutës, me formulimet “në mënyrë të vazhdueshme është vlerësuar me performancë të pamjaftueshme” ose “ka bërë shkelje të rënda disiplinore”, nuk pakësojnë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës; (iii) njëzëri, që amendamentet e propozuara kushtetuese nr.27 dhe nr.28, përmes të cilave propozohet plotësimi i kriterit kushtetues për shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve për shkak të “mosrespektimit të rëndë të detyrave”, i përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 104 [Emërimi dhe Shkarkimi i Gjyqtarëve] dhe paragrafin 6 të nenit 109 [Prokurori i Shtetit] të Kushtetutës, me formulimin “është vërtetuar se ka pasuri të pajustificueshme” me vendim gjyqësor përfundimtar, nuk pakësojnë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës; ndërsa (iv) njëzëri, që amendamentet e propozuara kushtetuese nr.27 dhe nr.28, përmes të cilave propozohet plotësimi i kriterit kushtetues për shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, për shkak të “mosrespektim të rëndë të detyrave”, i përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 104 [Emërimi dhe Shkarkimi i Gjyqtarëve] dhe paragrafin 6 të nenit 109 [Prokurori i Shtetit] të Kushtetutës, me formulimin “ka integritet të cenueshëm”, pakësojnë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës.

Aktgjykimi fillimisht sqaron që, amendamentet e propozuara kushtetuese të referuara në Gjykatë nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe të aprovuara nga Komisioni ad hoc për Vetingun në sistemin e drejtësisë, i themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, ndërlidhen me (i) procesin kalimtar/të përkohshëm të kontrollit të integritetit të anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Këshillit Prokurorial të Kosovës, kryetarëve të të gjitha gjykatave, Kryeprokurorit të Shtetit dhe të gjithë kryeprokurorëve si dhe të kandidatëve për këto pozita, përkatësisht procesin e vetingut në sistemin e drejtësisë; dhe (ii) zgjerimin/plotësimin e bazave të përhershme kushtetuese për shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Kosovës. Aktgjykimi, gjithashtu sqaron që procesi i përgatitjes së amendamenteve kushtetuese, ka filluar me (i) miratimin e “Koncept-dokumentit për zhvillimin e procesit të Veting-ut në sistemin e drejtësisë” nga Qeveria, më 13 tetor 2021; dhe (ii) dorëzimin e Koncept-dokumentit dhe amendamenteve të

propozuara kushtetuese nga Ministria e Drejtësisë për opinion në Komisionin e Venecias, më 10 shkurt 2022 dhe 18 maj 2022. Më 17-18 qershor 2022, Komisioni i Venecias në mbledhjen plenare të 131-të miratoi Opinionin [nr. CDL-AD(2022) 011] për Koncept-dokumentin për Veting-un e gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe projekt-amendamentet kushtetuese, të cilin e publikoi më 20 qershor 2022. Ky Opinion, ndër tjerash, thekson që (i) kontrolli i integritetit, përkatësisht vetingu në sistemin e drejtësisë, mund të bëhet vetëm përmes amendamenteve kushtetuese; (ii) për të siguruar një reformë proporcionale, procesi kalimtar/i përkohshëm i kontrollit të integritetit, duhet të kufizohet vetëm në anëtarët e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Këshillit Prokurorial të Kosovës, kryetarët e gjykatave dhe kryeprokurorët; (iii) çështjet tjera që ndërlidhen me integritetin e sistemit gjyqësor dhe prokurorial, përkatësisht gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Kosovës, duhet të mbeten në kompetencën e Këshillave përkatës dhe të realizohen përmes reformave ligjore dhe përfundimit të mekanizmave ekzistues në ligjet e aplikueshme të Republikës së Kosovës; (iv) ndërhyrja në të drejtat kushtetuese duhet të jetë rreptësisht proporcionale dhe që çdo ndryshim kushtetues duhet të synojë ndërhyrje minimale në kompetencat e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës; dhe (v) ndryshimet përkatëse kushtetuese dhe legjislative duhet të përgatiten mbi bazën e një dialogu të sqartë dhe në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha palët e interesit, përfshirë Ministrinë e Drejtësisë, Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial, si dhe shoqërinë civile dhe akademikët e interesuar.

Në kuptim të fushëveprimit të vlerësimit kushtetues të amendamenteve të propozuara kushtetuese, Aktgjykimi më tej sqaron që vlerësimi i kushtetutshmërisë së amendamenteve të propozuara, sipas paragrafit 3 të nenit 144 [Amendamenti] të Kushtetutës, është i kufizuar në vlerësimin nëse amendamenti i propozuar kushtetues pakëson ndonjë nga të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës. Sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, një vlerësim i tillë i nënshtrohet edhe përputhshmërisë së amendamenteve të propozuara me vlerat e rendit kushtetues të Republikës së Kosovës të saktësuara në nenin 7 [Vlerat] të Kushtetutës dhe detyrimeve që burojnë nga neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] i Kushtetutës, përmes të cilit saktësohet që të drejtat e njeriut duhet të interpretohen në harmoni me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjykata, gjatë vlerësimit të amendamenteve të propozuara kushtetuese, ndër tjerash, mori për bazë



dokumentacionin e dorëzuar në Gjykatë nga Kryetari i Kuvendit dhe komentet dhe përgjigjet në komente, të dorëzuara nga (i) Zyra e Presidentes së Republikës së Kosovës; (ii) Ministria e Drejtësisë; (iii) Këshilli Gjyqësor i Kosovës; (iv) Këshilli Prokurorial i Kosovës; si dhe (v) një deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës. Për më tepër, dhe në vlerësimin nëse amendamentet e propozuara kushtetuese pakësojnë të drejtat dhe liritë themelore të përcaktuara me Kapitullin II të Kushtetutës, Aktgjykimi fillimisht shtjellon (i) parimet themelore të Kushtetutës përkitazi me ndarjen dhe balancimin e pushteteve dhe pavarësinë e pushtetit gjyqësor dhe sistemit prokurorial në rendin juridik të Republikës së Kosovës; (ii) parimet dhe standardet përkitazi me pavarësinë e gjyqësorit dhe të prokurorisë që burojnë nga instrumentet dhe dokumentet ndërkombëtare, përfshirë ato të Kombeve të Bashkuara, të Bashkimit Evropian, të Këshillit të Evropës, përfshirë rekomandimet e Komitetit të Ministrave dhe Opinionet e Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë dhe Këshillit Konsultativ të Prokurorëve Evropianë, Opinionet relevante të Komisionit të Venecias, praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian; (iii) parimet e përgjithshme që burojnë nga Kushtetuta dhe standardet e instrumentet ndërkombëtare përkitazi me kriteret për shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve; (iv) Opinionet dhe përgjigjet amicus curiae të Komisionit të Venecias në lidhje me vlerësimin kalimtar (vetingun) të gjyqtarëve dhe prokurorëve, përfshirë në rastin e Republikës së Shqipërisë, Moldavisë dhe Ukrainës; (v) analizën krahasuese të Kushtetutave të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës; dhe (vi) Opinionin nr.CDL-AD (2022)011 të Komisionit të Venecias për Kosovën përkitazi me Koncept-Dokumentin për Vetingun e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Aktgjykimi më tej sqaron që, amendamentet e propozuara kushtetuese janë të dy kategorive. Kategoria e parë, përkatësisht amendamenti i propozuar kushtetues nr. 29, është i natyrës kalimtare/të përkohshme dhe përfshinë propozimin që ndërlidhet me procesin e vetingut në sistemin e drejtësisë, përkatësisht themelimin e Autoritetit, si organ i përkohshëm, i themeluar jashtë sistemit gjyqësor dhe atij prokurorial, i cili është i mveshur me kompetencën e kontrollit të integritetit të anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Këshillit Prokurorial të Kosovës, kryetarëve të gjykatave, Kryeprokurorit të Shtetit, kryeprokurorëve të prokurorive dhe kandidatëve për këto pozita. Ndërsa, kategoria e dytë, përkatësisht amendamentet e propozuara nr.27 dhe nr.28, janë të natyrës së përhershme dhe propozojnë

zgjerimin/plotësimin e bazës ekzistuese kushtetuese për shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve për shkak të “mosrespektimit të rëndë të detyrave” të përcaktuar me paragrafin 4 të nenit 104 [Emërimi dhe Shkarkimi i Gjyqtarëve] dhe paragrafin 6 të nenit 109 [Prokurori i Shtetit] të Kushtetutës. Në aplikimin e parimeve kushtetuese dhe standardeve relevante ndërkombëtare, përfshirë ato që burojnë nga Opinioni i Komisionit të Venecias për Kosovë, Gjykata ka konstatuar që (i) amendamenti i propozuar nr.29, që ndërlidhet me procesin kalimtar/të përkohshëm të vetingut në sistemin e drejtësisë, nuk pakëson të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës; ndërsa (ii) amendamentet e propozuara nr.27 dhe nr.28, që ndërlidhen me plotësimin e bazave kushtetuese të përhershme për shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, nuk pakësojnë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës në kontekst të tri (3) prej formulimeve të propozuara, ndërsa i pakësojnë këto të drejta dhe liri në kontekst të një (1) formulimi të propozuar, sipas sqarimeve të dhëna në vijim:

*(i) procesi kalimtar/i përkohshëm i kontrollit në sistemin e drejtësisë – vetingu*

Aktgjykimi fillimisht sqaron që amendamenti i propozuar kushtetues nr.29, përcakton (i) krijimin e mekanizmit të kontrollit të integritetit të pozitave udhëheqëse në sistemin e drejtësisë, përmes Autoritetit për Kontrollin e Integritetit; (ii) mandatin e përkohshëm të Autoritetit për një periudhë dy (2) vjeçare, me mundësi vazhdimi edhe për një (1) vit, nëse vendoset me ligj të miratuar nga dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve të Kuvendit dhe përcaktimin që kontrolli i integritetit, përfshirë kontrollin e pasurisë dhe të figurës së subjektit të kontrollit, bëhet vetëm një herë; (iii) që përbërja, përzgjedhja, organizimi, funksionimi, kompetencat dhe imuniteti i Autoritetit, përcaktohen me ligj; (iv) përbërjen dhe kompetencat e paneleve të kontrollit të integritetit dhe Kolegjit përkatës të Apelit, përfshirë sipas përcaktimeve të mëtejshme me ligj; (v) kompetencën e Presidentes së Republikës për të organizuar procesin e zgjedhjes së anëtarëve të Autoritetit dhe të cilët votohen në bllok dhe zgjedhen me votat e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve të Kuvendit dhe shkarkohen me të njëjtën shumicë pas propozimit të Kolegjit të Apelit të Autoritetit; (vi) kompetencën e Autoritetit që të konfirmojë kalimin e kontrollit të integritetit për subjektin përkatës apo t'i propozojë Presidentes shkarkimin e të njëjtit; (vii) detyrimin për bashkëpunim nga subjekti i kontrollit; dhe (viii) të drejtën e ankesës në Kolegjin e Apelit të Autoritetit dhe në Gjykatën Kushtetuese.



Në vlerësimin e këtij amendamenti kushtetues, Aktgjykimi fillimisht thekson që themelimi i Autoritetit, i cili mvshet me kompetencën për kontrollin e integritetit “të anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, anëtarëve të Këshillit Prokurorial të Kosovës, Kryetarëve të gjykatave, Kryeprokurorit të Shtetit dhe kryeprokurore të prokurorive dhe kandidatëve për këto pozita”, mund të përcaktohet vetëm përmes amendamenteve kushtetuese, duke marrë parasysh që kompetencat e Autoritetit të lartcekur afektojnë (i) kompetencat kushtetuese, përfshirë pavarësinë e plotë kushtetuese të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës, sipas përcaktimeve të neneve 108 [Këshilli Gjyqësor i Kosovës] dhe 110 [Këshilli Prokurorial i Kosovës] të Kushtetutës; (ii) kompetencat kushtetuese të Presidentit të Republikës të përcaktuara me paragrafët 15 dhe 17 të nenit 84 [Kompetencat e Presidentit] të Kushtetutës; dhe (iii) kompetencën kushtetuese të Kuvendit të përcaktuar përmes paragrafit 10 të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës.

Në vijim, Aktgjykimi sqaron që përtej efektit të përkohshëm në kompetencat kushtetuese të institucioneve të lartcekura, themelimi i Autoritetit gjithashtu afekton (i) të drejtat e subjekteve të kontrollit të integritetit, përkatësisht anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Këshillit Prokurorial të Kosovës, kryetarëve të të gjitha gjykatave dhe të gjithë kryeprokurore si dhe kandidatëve për këto pozita; por edhe (ii) të drejtat dhe liritë themelore të të gjithë qytetarëve, sepse një proces i tillë që përfshin kontrollin e integritetit të pozitave drejtuese, të cilat janë përgjegjëse për funksionimin dhe administrimin e gjithmbarshëm të sistemit të drejtësisë, mund të ndikojë në administrimin e rasteve të individëve para gjykatave dhe prokurorive dhe rrjedhimisht, në të drejtën e tyre kushtetuese për gjykim të drejtë. Marrë parasysh efektin e themelimit të Autoritetit në rendin kushtetues të Republikës së Kosovës, Aktgjykimi shtjellon dhe vlerëson të gjitha amendamentet e propozuara kushtetuese veç e veç, me theks në analizën (i) nëse Autoriteti, përkatësisht panelet e kontrollit dhe Kolegji i Apelit, plotësojnë kriteret e “tribunalit/gjykatës” së pavarur të themeluar me ligj sipas garancive që ndërthen neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; (ii) nëse subjektet që i nënshtrohen kontrollit të integritetit nga Autoriteti, kanë të garantuar të drejtën për qasje në drejtësi, mjet juridik dhe mbrojtje gjyqësore të të drejtave sipas përcaktimeve të neneve 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm],

32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; dhe (iii) nëse kontrolli i integritetit përmes mekanizmave të Autoritetit, cenon të drejtat e privatësisë të subjekteve përkatëse në kundërshtim me garancitë e nenit 36 [E Drejta e Privatësisë] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Në kontekst të çështjes së parë, dhe duke aplikuar praktikën relevante gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Gjykata vlerësoi kriteret që ndërlidhen me (i) funksionin gjyqësor të paneleve të kontrollit dhe Kolegjit të Apelit të Autoritetit; (ii) mënyrën e zgjedhjes dhe shkarkimit të anëtarëve të Autoritetit; dhe (iii) konceptin e pavarësisë dhe paansisë së paneleve të kontrollit dhe Kolegjit të Apelit dhe kohëzgjatjen e mandatit të anëtarëve të Autoritetit; dhe konstatoi që, në parim, panelet e kontrollit dhe Kolegji i Apelit i Autoritetit kanë statusin e “gjykatës/tribunalit” në kuptim të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në kontekst të çështjes së dytë, përkatësisht të drejtës së subjekteve të kontrollit për qasje në gjykatë dhe mjet efektiv juridik, Aktgjykimi, ndër tjerash, sqaron që megjithëse amendamentet e propozuara kushtetuese përjashtojnë të drejtën në mjete juridike para gjykatave të rregullta ndaj vendimeve të Autoritetit, të njëjtat garantojnë parimin e dyshkallshmërisë, përkatësisht të drejtën e ankesës ndaj vendimeve të paneleve të kontrollit në Kolegjin e Apelit të Autoritetit dhe të drejtën e parashtrimit të kërkesës për vlerësim të kushtetutshmërisë së vendimit të Kolegjit të lartcekur të Apelit në Gjykatën Kushtetuese, sipas përcaktimeve të paragrafit 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës. Ndërsa, në kontekst të çështjes së tretë, përkatësisht të drejtës së privatësisë, Aktgjykimi, duke shtjelluar parimet e përcaktuara përmes nenit 36 [E Drejta e Privatësisë] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sqaron që çështja e të dhënave, por edhe çështja e shkarkimit të subjekteve të kontrollit, bie në sferën e të drejtës për jetë private dhe familjare dhe që çdo “ndërrhyrje/kufizim” i kësaj të drejte, duhet të jetë e “përcaktuar me ligj”, të “ndjek qëllimin legjitim” dhe të jetë “proporcionale” dhe e nevojshme në një shoqëri demokratike. Në parim, Aktgjykimi sqaron që qëllimi i



qëllimi i kontrollit kalimtar/të përkohshëm të subjekteve të kontrollit të integritetit, ndjek një qëllim legjitim, përkatësisht atë të administrimit të duhur të drejtësisë dhe që mekanizmat e përcaktuara, në parim, janë proporcionale me qëllimin e ndjekur.

Thënë këtë, Aktgjykimi gjithashtu, ndër tjerash, thekson që (i) votimi i anëtarëve të Autoritetit në bllok me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve, ndërthen detyrimin e Kuvendit për të vlerësuar dhe për t'u siguruar që çdo kandidat për anëtar të Autoritetit, në baza individuale, të përmbushë kriteret më të larta profesionale dhe të integritetit; (ii) përbërja e Autoritetit dhe emërimet e reja në pozitat që i nënshtrohen kontrollit të integritetit, duhet të jenë në përputhje me detyrimet kushtetuese për barazinë gjinore dhe përfaqësimin e anëtarëve të komunitetit joshumicë; dhe (iii) bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, çdo “ndërrhyrje/kufizim” në të drejtën për jetën private përmes procedurave të kontrollit të integritetit të zhvilluara nga Autoriteti, duhet të jetë rreptësisht proporcionale me qëllimin e ndjekur. Për më tepër, Aktgjykimi gjithashtu thekson që bazuar në amendamentet e propozuara kushtetuese, mandati i Autoritetit është dy (2) vite nga zgjedhja e të gjithë anëtarëve të tij, me mundësi vazhdimi më së shumti edhe për një (1) vit tjetër, nëse vendoset me ligj të miratuar me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit. Aktgjykimi sqaron që dështimi i miratimit të këtij ligji, nënkupton përfundimin e menjëhershëm të mandatit të Autoritetit. Në fund, Aktgjykimi gjithashtu thekson që vlerësimi i Gjykatës që amendamenti i propozuar kushtetues nr. 29, nuk rezulton në pakësimin e të drejtave dhe lirive themelore të përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës, nuk paragjykon edhe vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjit të Kuvendit që miratohet në zbatim të amendamentit të lartcekur, për aq sa kontestohet para Gjykatës përmes palëve të autorizuara sipas përcaktimeve të Kushtetutës.

*(ii) plotësimi/zgjerimi i bazave të përhershme kushtetuese për shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve*

Aktgjykimi fillimisht sqaron që bazuar në paragrafin 4 të nenit 104 [Emërimi dhe Shkarkimi i Gjyqtarëve] dhe paragrafin 6 të nenit 109 [Prokurori i Shtetit] të Kushtetutës, gjyqtarët dhe prokurorët mund të shkarkohen nga funksioni për shkak të (i) “dënimit për një vepër të rëndë penale”; ose për (ii) “mosrespektimin e rëndë të detyrave”, ndërsa, bazuar në paragrafin 2 të nenit 107 [Imuniteti] të Kushtetutës, gjyqtarët nuk gëzojnë imunitet dhe mund të shkarkohen nga funksioni, kur të kenë shkelur ligjin

me qëllim. Për më tepër, sipas shtjellimeve në Aktgjykim, Ligji nr.06/L-57 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe aktet e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës, përcaktojnë më tej llojet e shkeljeve disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, përfshirë ato që ndërlidhen me “shkelje të ligjit” ose “shkelje të detyrave zyrtare”, sanksionet përkatëse dhe propozimin për shkarkim të gjyqtarit ose të prokurorit përkatës. Amendamentet e propozuara kushtetuese nr.27 dhe nr.28, propozojnë zgjerimin/plotësimin e bazës kushtetuese të “mosrespektimit të rëndë të detyrave”, duke përfshirë në nivel të normës kushtetuese edhe (i) “performancën e pamjaftueshme në mënyrë të vazhdueshme”; (ii) “pasurinë e pajustificueshme”; (iii) “shkeljet e rënda disiplinore”; dhe (iv) “integritetin e cenueshëm”.

Në vlerësimin nëse amendamentet e propozuara si më sipër, pakësojnë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës, Aktgjykimi, ndër tjerash, sqaron që (i) për dallim nga kontrolli kalimtar i integritetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve si masë e përkohshme dhe e jashtëzakonshme, element thelbësor i pavarësisë së pushtetit gjyqësor dhe sistemit prokurorial, është edhe parimi i sigurisë që ndërlidhet me mandatin dhe palargueshmërinë nga funksioni; dhe (ii) bazat e përhershme për shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, duhet të mundësojnë ndërmarrjen e masave efektive ndaj atyre që cenojnë integritetin e sistemit të drejtësisë, por në të njëjtën kohë, të ofrojnë garanci që të njëjtit të ushtrojnë funksionet përkatëse në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe pa ndërrhyrje. Për pasojë, instrumentet ndërkombëtare, përfshirë Opinionet e Komisionit të Venecias dhe Opinionet e Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë, përcaktojnë detyrimin që bazat për disiplinimin dhe/ose shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve duhet të jenë qartësisht të përcaktuara, përfshirë sa i përket garancive procedurale që duhet ndjekur. Një parim i tillë, buron edhe nga parimi i sigurisë juridike, si pjesë thelbësore e sundimit të ligjit, sipas të cilit, norma duhet të jetë në përputhje me kriterin e “qartësisë” dhe “parashikueshmërisë”.

Në kontekstin e lartcekur, Aktgjykimi thekson që Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe ligjet relevante të aplikueshme, përcaktojnë bazë të mjaftueshme për shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Për më tepër, çështjet që ndërlidhen me vlerësimin e performancës dhe shkeljeve të rënda disiplinore, bazuar në Kushtetutë dhe Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, tashmë përbëjnë bazë për propozimin për shkarkim të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Në



Opinionin për Kosovën, edhe Komisioni i Venecias, ka rekomanduar që përtej kontrollit kalimtar/të përkohshëm të integritetit, të fokusuar në pozitat e larta të sistemit gjyqësor dhe prokurorial, çështjet që ndërlidhen me integritetin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të tjerë të Republikës së Kosovës, të administrohen nga Këshillat përkatës, duke përfunduar zbatimin e mekanizmave ekzistues ligjor, por edhe përmes miratimit/amendamentimit të ligjeve relevante. Megjithatë, sipas shtjellimeve të dhëna në Aktgjykim, Gjykata konsideron që nëse propozuesi i amendamenteve kushtetuese vlerëson që kriteret të tilla që ndërlidhen me “performancën profesionale”, “shkeljet e rënda disiplinore” dhe “pasurinë e pajustificueshme” të gjyqtarit dhe/ose prokurorit e të vërtetuar me vendim gjyqësor përfundimtar, duhet të përcaktohen edhe në nivel të normës kushtetuese, një përcaktim i tillë është i mundur, sepse formulimet e lartcekura janë mjaftueshëm të “qarta” dhe të “parashikueshme”, dhe si të tilla, nuk rezultojnë në pakësimin e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Në kontekst të formulimit “është vërtetuar se ka pasuri të pajustificueshme”, Aktgjykimi, ndër tjerash, sqaron që (i) mekanizmi i deklarimit të pasurisë, është një ndër mekanizmat e luftimit të korrupsionit në sektorin publik, përfshirë për gjyqtarët dhe prokurorët, dhe si i tillë, i njëjti mund të rezultojë në shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve; (ii) mekanizmit të deklarimit të pasurisë të përcaktuar përmes Ligjit nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave, i referohet edhe Komisioni i Venecias në Opinion e tij për Kosovën, e mekanizmave të ngjashme i referohen edhe opinionet tjera relevante, përfshirë ato të Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Evropianë dhe praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; dhe (iii) Kodi Penal i Republikës së Kosovës, përcakton veprën penale “mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare”, dhe dënimi për të njëjtën, bazuar në Kushtetutë, rezulton në propozimin për shkarkim të gjyqtarit dhe/ose prokurorit përkatës. Aktgjykimi, megjithatë, sqaron që asnjë nga Kushtetutat e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe as të Këshillit të Evropës nuk e kanë të përcaktuar “pasurinë e pajustificueshme” në nivel të normës kushtetuese si bazë për shkarkimin e gjyqtarëve dhe/ose prokurorëve.

Thënë këtë, sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, (i) përderisa nuk është kontestuese që mos raportimi dhe/ose raportimi i rremë i pasurisë aktualisht përbën bazë për shkarkimin e gjyqtarit dhe/ose prokurorit; dhe (ii) që koncepti i “pasurisë së pajustificueshme”

dallon nga vepra e lartcekur penale, Aktgjykimi sqaron se, edhe “pasuria e pajustificueshme” e cila është e vërtetuar me vendim gjyqësor përfundimtar, mund të përbëjë bazë për shkarkimin e gjyqtarit dhe/ose prokurorit, duke iu nënshtruar garancive kushtetuese që ndërlidhen me (i) qasje në drejtësi, në kuptim të neneve 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës; si dhe (ii) të drejtën për gjykim të drejtë dhe paanshëm, në kuptim të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, Gjykata ka vlerësuar edhe bazën e propozuar për shkarkimin e gjyqtarit dhe/ose prokurorit, që ndërlidhet me formulimin e “integritetit të cenusshëm”. Aktgjykimi sqaron që çështjet që ndërlidhen me integritetin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, janë të mbuluara në mënyrë gjithëpërfshirëse nga bazat ekzistuese kushtetuese dhe ligjore e që mund të rezultojnë në shkarkimin e tyre. Megjithatë, në aplikimin e standardeve që burojnë nga parimet kushtetuese dhe instrumentet ndërkombëtare, formulimi “ka integritet të cenusshëm”, si bazë e përhershme e shkarkimit të gjyqtarit dhe/ose prokurorit, karakterizohet me mungesë të përkufizimit të “qartë” dhe të “parashikueshëm”. Për më tepër, në balancimin e (i) parimit të sigurisë së mandatit të gjyqtarit dhe/ose prokurorit dhe rëndësinë e këtij parimi për pavarësinë e sistemit gjyqësor dhe prokurorial, përfshirë gjykatën e pavarur dhe të themeluar me ligj sipas përcaktimeve të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; dhe (ii) “paqartësisë” dhe “paparashikueshmërisë” së formulimit të propozuar, përfshirë në kontekst të mungesës së garancive të nevojshme procedurale që ndërlidhen me vlerësimin e “integritetit të cenusshëm”, si bazë e përhershme për shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve që propozohet në nivel të normës kushtetuese, Gjykata konstatoi që një formulim i tillë, rezulton në pakësim të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës.

Aktgjykimi në fund thekson që nuk është kontestuese që pavarësia e pushtetit gjyqësor dhe sistemit prokurorial janë parime thelbësore të rendit kushtetues të Republikës së Kosovës, e cila bazohet në vlerat e sundimit të ligjit dhe të demokracisë. Kushtetuta e Republikës së Kosovës përcakton Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës, si dy institucione të pavarura



kushtetuese, duke u akorduar të njëjtave kompetencën e administrimit të sistemit gjyqësor dhe prokurorial, respektivisht, duke përfshirë edhe çështjet që ndërlidhen me procedurat disiplinore për gjyqtarë dhe prokurorë, dhe kompetencën për propozimin e shkarkimit të tyre. Këto kompetenca të Këshillave ngërthejnë edhe detyrimin, që të njëjtat, të veprojnë me efikasitetin e duhur në zbatimin e ligjeve të aplikueshme, përfshirë Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe të ndërmarrin masat e nevojshme ndaj çdo gjyqtari dhe prokurori që mund të cenojë integritetin e sistemit gjyqësor dhe prokurorial në Republikën e Kosovës. Aktgjykimi thekson që funksionimi dhe administrimi i mirëfilltë i drejtësisë, përfshirë edhe besimin e publikut në këtë sistem, reflekton një ndër parimet më esenciale të një shoqërie demokratike të bazuar në sundimin e ligjit, parim ky i cili është vlerë themelore e rendit kushtetues të Republikës së Kosovës.



### **Aktgjykim**

KI 43/23

### **Parashtrues**

Armend Hamiti

*Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së së Aktgjykimit [AA. nr. 37/22] të 18 janarit 2023, të Gjykatës Supreme të Kosovës*

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës ka vendosur lidhur me kërkesën në rastin KI43/23, me parashtrues Armend Hamiti, për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [AA. nr. 37/22] të 18 janarit 2023 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës në lidhje me Vendimin [KPK/ Nr. 1513/2022] të 29 nëntorit 2022 të Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), të dorëzuar në Gjykatë bazuar në paragrafin 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Gjykata, njëzëri, konstatoi se: (i) kërkesa është e pranueshme; (ii) ka pasur shkelje të paragrafit 1 të nenit 31 [E Drejta

për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës të Republikës së Kosovës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; dhe (iii) të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin [AA. nr. 37/22] e 18 janarit 2023, duke e kthyer të njëjtin në rishqyrtim në Gjykatën Supreme.

Rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me procedurat disiplinore të iniciuara nga Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore, në cilësinë e Autoritetit kompetent bazuar në ligjin e aplikueshëm, ndaj parashtruesit të kërkesës, i cili ushtron funksionin e Prokurorit në Departamentin për Krime të Rënda në Prokurorinë Themelore në Prishtinë. Procedurat e lartcekura ishin inicuar, pasi që përmes një portali, ishte publikuar një lajm me disa fotografi të një takimi në mes të parashtruesit të kërkesës dhe Sh.K., i dënuar për vepra të ndryshme penale. Si rrjedhojë, në bazë të shkresave të lëndës, KPK themeloi Panelin Hetimor për Zhvillimin e Hetimeve Disiplinore ndaj parashtruesit të kërkesës. Këtij paneli, më pas iu ndryshua përbërja nga kryesuesi i KPK-së, me qëllim të zëvendësimit të njërit nga anëtarët e panelit, me arsyetimin se i njëjti gjendej në pushim vjetor. Parashtruesi i kërkesës iu drejtua më pas Agjencisë për Parandalim të Korrupsionit (APK), nga e cila kërkoi që të vlerësojë nëse iniciimi i procedurës disiplinore nga eprori i parashtruesit të kërkesës, në cilësi të Autoritetit kompetent, paraqet konflikt të interesit. KPK suspendoi procedurën disiplinore deri në vendimmarrjen e APK-së, e cila pas shqyrtimit të kërkesës, konstatoi që iniciimi i procedurës disiplinore nga ana e eprorit të parashtruesit, nuk përbente konflikt të interesit.

Në ndërkohë, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga KPK (i) zëvendësimin e anëtarit të Panelit Hetimor me arsyetimin se njëjti është nxjerrë kundërligjshëm nga organi jokompetent, respektivisht kryesuesi i KPK-së dhe jo nga KPK si organ kolegjal; (ii) suspendimin e procedurës disiplinore me arsyetimin se i njëjta është zhvilluar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi; (iii) kontestoi mandatin e Panelit Hetimor me arsyetimin se të njëjtit i ka skaduar afati ligjor për ndërmarrjen e veprimeve hetimore; si dhe kërkoi (iv) përjashtimin e të gjithë anëtarëve të Panelit Hetimor, me arsyetimin se të gjithë anëtarët përkatës janë nga vendi i tij i lindjes.

Sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, (i) më 1 nëntor 2022, Paneli Hetimor ia dorëzoi KPK-së Raportin hetimor, sipas të cilit, veprimet e parashtruesit të kërkesës, kishin rezultuar në shkelje të nenit 6 (Shkeljet disiplinore për prokurorë) të Ligjit nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve; (ii) më 2 nëntor 2022,

KPK protokolloi vendimin për refuzimin e kërkesës së parashtruesit të kërkesës për përjashtimin e tre (3) anëtarëve të Panelit Hetimor, si dhe obligoi këtë fundit që të vazhdojë me zhvillimin e hetimeve dhe të dorëzojë raportin me shkrim brenda afatit të përcaktuar; ndërsa (iii) më 29 nëntor 2022, KPK e aprovoi Raportin hetimor si të bazuar dhe si pasojë i shqiptoi parashtruesit të kërkesës sanksionin disiplinor “Vërejtje publike me shkrim”. Ky vendim u vërtetua nga Gjykata Supreme.

Në kërkesën e tij drejtuar Gjykatës, parashtruesi i kërkesës pretendoi se KPK dhe Gjykata Supreme kanë cenuar të drejtën e tij kushtetuese për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 [E drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, pasi që nuk kanë arsyetuar vendimet e tyre, respektivisht, nuk kanë shqyrtuar fare pretendimet ankimore të tij, që ndërlidheshin, mes tjerash, (i) me kompetencën ligjore të kryesuesit të KPK-së për zëvendësimin e anëtarit të Panelit Hetimor; (ii) ligjshmërinë e suspendimit të procedurës disiplinore gjatë kohës sa rasti ishte në trajtim përkitazi me konfliktin e interesit në AKP; (iii) me pretendimin se Panelit Hetimor i kishte kaluar mandati si rezultat i skadimit të afatit ligjor për ndërmarrjen e veprimeve hetimore; si dhe (iv) procedimin e raportit të Panelit Hetimor në KPK përderisa kjo e fundit ende nuk kishte marrë vendim lidhur me kërkesën e përjashtimit të anëtarëve të këtij paneli.

Me qëllim të adresimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata fillimisht (i) shtjelloi parimet e përgjithshme lidhur me të drejtën për vendim të arsyetuar gjyqësor, siç garantohen përmes nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut; dhe (ii) më pas i zbatoi të njëjtat në rrethanat e rastit konkret. Në këtë kontekst dhe sipas parimeve të përgjithshme dhe dispozitave relevante në fuqi, të shtjelluara në mënyrë të detajuar në Aktgjykim, Gjykata vlerësoi se Gjykata Supreme përmes vendimit të kontestuar nuk kishte adresuar pretendimet thelbësore të ngritura nga parashtruesi i kërkesës që ndërlidheshin, mes tjerash, me (i) ligjshmërinë e përbërjes së Panelit Hetimor; (ii) suspendimin e procedurës disiplinore; si dhe (iii) vendosjen e rastit nga Paneli hetimor jashtë afatit ligjor. Për pasojë, Gjykata me qëllim që vendimi i Gjykatës Supreme të jetë në përputhje me të drejtën e parashtruesit të kërkesës për një vendim të arsyetuar gjyqësor, ktheu të njëjtën në rishqyrtim nga Gjykata

Supreme. Aktgjykimi sqaron që konstatimet e Gjykatës në këtë Aktgjykim ndërlidhen vetëm me garancitë procedurale, përkatësisht të drejtën e parashtruesit të kërkesës për një proces të paanshëm dhe pavarur gjyqësor në kontekst të vendimit të arsyetuar gjyqësor. Aktgjykimi nuk paragjykon epilogun e procedurave të mëtejme gjyqësore. Për më tepër, Aktgjykimi vë theks në faktin që parashtruesi i kërkesës, përkatësisht prokurorët janë të mveshur me petkun e ushtrimit të një detyre zyrtare, që ngërthen përgjegjësi të larta në kontekst të administrimit të drejtësisë brenda sistemit juridik të Republikës së Kosovës. Detyrat dhe kompetencat e prokurorëve ngërthejnë detyrimin e ushtrimit të funksionit në mënyrë të pavarur, paanshme, të drejtë dhe objektive, duke zbatuar standardet më të larta të kujdesit, sjelljes së ndershme dhe profesionale, me qëllim të ruajtjes së integritetit të institucionit, përfshirë duke zbatuar parimin kyç në drejtësi të sigurimit të trajtimit të barabartë para ligjit, pa diskriminim të asnjë lloji, duke respektuar të drejtat dhe liritë e qytetarëve të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe instrumenteve ndërkombëtare, të cilat zbatohen drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës.



## **Aktgjykim**

KI 103/23

## **Parashtrues**

Zyra e Rregullatorit për Energji e Republikës së Kosovës

*Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [Arj.nr.116/2022] të 9 marsit 2023 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës*

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës ka vendosur lidhur me kërkesën në rastin KI103/23, me parashtrues: Zyra e Rregullatorit për Energji e Republikës së Kosovës, për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [Arj.nr.116/2022] të 9 marsit 2023, të Gjykatës Supreme të Republikës së





Kosovës, të dorëzuar në Gjykatë bazuar në paragrafin 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Gjykata, njëzëri, konstatoi që: (i) kërkesa është e pranueshme; dhe (ii) Aktgjykimi [Arj.nr.116/2022] i 9 marsit 2023 i Gjykatës Supreme, nuk është në kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me padinë e Avokatit të Popullit (i) për anulimin si të kundërligjshëm të Vendimit të 6 shkurtit 2012 të Zyrës së Rregullatorit për Energji “për reduktimin e humbjeve të shpërndarjes së energjisë elektrike”; si dhe (ii) kërkesën për kompensimin e dëmit konsumatorëve të cilët janë faturuar për shpenzimin e energjisë elektrike në katër (4) komunat veriore të Republikës së Kosovës. Avokati i Popullit para gjykatave të rregullta kishte pretenduar, ndër tjerash, që (i) faturimi i energjisë elektrike të shpenzuar në katër (4) komunat veriore të Republikës së Kosovës tek konsumatorët e tjerë që banojnë në komunat tjera të Republikës së Kosovës, paraqet shkelje të Ligjit nr.05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë dhe Ligjit nr.05/L-085 për Energjinë Elektrike; dhe (ii) kjo praktikë e faturimit paraqet shkelje të së drejtës në pronë të garantuar me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës dhe shkelje të së drejtës për barazi para ligjit të garantuar me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës.

Pas vlerësimit të pretendimeve të Avokatit të Popullit, Gjykata Themelore kishte anuluar si të kundërligjshëm Vendimin e lartcekur të Zyrës për Rregullatorin për Energji dhe kishte urdhëruar kthimin e shumës së faturuar, respektivisht kompensimin e dëmit konsumatorëve të cilët janë faturuar për shpenzimin e energjisë elektrike në katër (4) komunat veriore të Republikës së Kosovës për periudhën 6 shkurt 2012 deri më 20 tetor 2017, në vlerën prej dyzet milionë e tetëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e katërqind e tetëdhjetë euro (40.855.480.00 EUR). Konstatimi i Gjykatës Themelore, u konfirmua nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme. Sipas gjykatave të rregullta, në esencë dhe ndër tjerash, pavarësisht që Zyra për Rregullatorin për Energji ka kompetencën lidhur me trajtimin e parametrave rregullative dhe faturimin e kostos së rrymës së humbur në sistemin e transmisionit dhe shpërndarjes, të faturuarit e humbjeve të shkaktuara në katër (4) komunat veriore të Republikës së Kosovës tek konsumatorët tjerë të Republikës së Kosovës, kishte rezultuar në trajtim të pabarabartë të qytetarëve, në kundërshtim me

përcaktimet e nenit 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës dhe Ligjit nr.05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, sepse nuk ka pasur qëllim legjitim dhe proporcionalitet ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit të synuar.

Parashtruesi i kërkesës, përkatësisht Zyra e Rregullatorit për Energji, para Gjykatës kontestoi vendimmarrjen e gjykatave të rregullta, duke pretenduar që të njëjtat janë nxjerrë në shkelje të të drejtave të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si rezultat i (i) zbatimit qartazi të gabuar të ligjit; si dhe (ii) mungesës së arsytimit të vendimit gjyqësor.

Në vlerësimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, përkatësisht Zyrës për Rregullatorin për Energji, Gjykata fillimisht shtjelloi parimet e përgjithshme të praktikës së saj gjyqësore dhe asaj të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkitazi me (i) interpretimin qartazi të gabuar të ligjit; si dhe (ii) të drejtës për vendim të arsyetuar gjyqësor, siç garantohen me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe më pas (ii) i zbatoi të njëjtat në rrethanat e rastit konkret. Sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, gjykatat e rregullta kishin marrë parasysh dhe vlerësuar pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës dhe duke u referuar në dispozitat kushtetuese dhe ato të ligjeve të aplikueshme, përfshirë (i) nenet 4 (Të drejtat e konsumatorit) dhe 12 (Fatura) të Ligjit nr.04/L-121 për Mbrojtjen e Konsumatorit, të cilat garantojnë të drejtat themelore të konsumatorit, e ku përfshihet edhe e drejta e mbrojtjes së interesave ekonomike të konsumatorit dhe e drejta për të mbrojtur pronën, si dhe (ii) nenin 194 (Rregullat e përgjithshme) të Ligjit nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve për sa i përket pasurimit të pabazë dhe detyrimit të parashtruesit të kërkesës që të bëjë kompensimin e dëmit për konsumatorët të cilët janë faturuar për shpenzimin e rrymës në katër (4) komuna të Republikës së Kosovës, përgjatë periudhës 6 shkurt 2012 deri më 20 tetor 2017, kishin konstatuar që një praktikë e tillë e faturimit nuk është e autorizuar me ligj dhe konsiston në trajtim jo të barabartë të qytetarëve të katër (4) komuna në raport me qytetarët në pjesën tjetër të Republikës së Kosovës. Në vijim, për sa i përket ndërlidhjes së pretendimeve të Zyrës për Rregullatorin për Energji me të gjeturat e Gjykatës në Aktgjykimin KO93/21, me parashtrues Blerta Deliu -Kodra dhe 12 deputetë të tjerë, Aktgjykimi sqaron që

ky rast dallon në mënyrë përmbajtësore nga rrethanat e rastit konkret, ndër tjerash, sepse në rastin KO93/21, Gjykata kishte vlerësuar kushtetutshmërinë e Rekomandimeve [Nr.08-R-01] të 6 majit 2021 të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas të cilave (i) ishte autorizuar KOSTT që të mbulojë devijimet e energjisë elektrike në katër (4) komuna të Republikës së Kosovës, duke shfrytëzuar të hyrat nga buxheti vetanak, mjete këto të cilat do të kompensohen “nga dividenda apo ndonjë mekanizëm tjetër i mundshëm”; dhe (ii) ishte detyruar Qeveria e Kosovës, që brenda afatit gjashtë (6) muajor të sigurojë të gjithë procesin e futjes në sistemin e faturimit, sipas rregullave dhe ligjeve në fuqi, në bashkëpunim me palët përgjegjëse, për faturimin e konsumatorëve në katër (4) komunat përkatëse me energji elektrike. Sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykimin KO93/21, Gjykata, kishte konstatuar që akti i kontestuar i Kuvendit nuk është në kundërshtim me dispozitat përkatëse të Kushtetutës, ndër tjerash, sepse dallimi në trajtimin e konsumatorëve të energjisë elektrike në bazë të vendbanimit, (i) ndjekte qëllimin legjitim të zbatimit të marrëveshjes së Kyçjes me ENTSO-E, përkatësisht Rrjetin Evropian të Operatorëve të Sistemit të Transmisionit për Energjinë Elektrike; dhe (ii) ishte i natyrës së përkohshme. Marrë parasysh dispozitat ligjore, qëllimin legjitim dhe përkohshmërinë e aktit të kontestuar të Kuvendit, përfshirë detyrimin e Qeverisë që të adresojë çështjet që ndërlidhen me sistemin përkatës të faturimit, Gjykata kishte vlerësuar që i njëjti ishte proporcional me qëllimin e ndjekur.

Rrjedhimisht, Gjykata, duke aplikuar kriteret dhe parimet e elaboruara përkitazi me vendimin e arsyetuar gjyqësor, dhe në veçanti duke u bazuar në interpretimin e dhënë përmes Aktgjykimeve të gjykatave të rregullta të kontestuara para Gjykatës, konstatoi që të njëjtat kanë adresuar dhe u janë përgjigjur të gjitha pretendimeve thelbësore të parashtruesit të kërkesës të ngritura përmes përgjigjes në padi, përkatësisht ankesës, si dhe kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, dhe konstatoi që Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, nuk është në kundërshtim me dispozitat e kontestuara të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.





## GJEDNJ – Vendime të rëndësishme (1 janar – 30 qershor 2024)

### \* **Dënimi penal i parashtruesit të kërkesës për shpifje publike pas pretendimeve të ngacmimit psikologjik dhe seksual ka shkelur nenin 10 të Konventës(18/01/2024)**

Në aktgjykimin e Dhomës së saj në rastin **Allée kundër Francës** (kërkesa nr. 20725/20), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut konstatoi, njëzëri, se kishte pasur: **shkelje të nenit 10 (liria e shprehjes)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Rasti kishte të bënte me dënimin penal të parashtrueses së kërkesës për shpifje publike pas pretendimeve të saj për ngacmim dhe sulm seksual kundër një drejtuesi të lartë të shoqatës jofitimprurëse ku ajo punonte. Pretendimet u ishin dërguar me email gjashtë personave brenda dhe jashtë shoqatës. Gjykata theksoi nevojën, në bazë të nenit 10, për të ofruar mbrojtje të përshtatshme për individët që pretendojnë se ata i ishin nënshtruar ngacmimeve psikologjike ose seksuale. Në rastin konkret, Gjykata vlerësoi se refuzimi i gjykatave të brendshme për të përshtatur konceptin e bazës së mjaftueshme faktike dhe kriteret për vlerësimin e mirëbesimit me rrethanat e rastit, kishte vendosur një barrë të tepruar të provës mbi parashtruesen e kërkesës, duke kërkuar që ajo të sigurojë prova për aktet që ajo dëshironte t'i raportonte. Gjykata gjithashtu theksoi se emaili, i dërguar nga parashtruesja e kërkesës gjashtë personave nga të cilët vetëm njëri kishte qenë palë e jashtme, kishte pasur vetëm një ndikim të vogël në reputacionin e ngacmuesit të saj të pretenduar.

Në fund, edhe pse dënimi financiar i vendosur ndaj parashtrueses së kërkesës nuk mund të përshkruhet si veçanërisht i rëndë, ajo megjithatë ishte dënuar për një vepër penale. Nga natyra e tij, një dënim i tillë kishte një efekt rrëqethës, i cili mund t'i dekurajonte njerëzit të raportonin veprime të tilla serioze si ato që, sipas tyre, çojnë në ngacmim psikologjik ose seksual, apo edhe sulm seksual.

Gjykata konkludoi se nuk kishte pasur marrëdhënie të arsyeshme të proporcionalitetit midis kufizimit të së drejtës së parashtrueses së kërkesës për lirinë e shprehjes dhe qëllimit legjitim të ndjekur, dhe konstatoi se për rrjedhojë kishte pasur shkelje të nenit 10 të Konventës.

### \* **Zbulimi i identitetit dhe të dhënave mjekësore të prostitutave të diagnostikuara me HIV ishte shkelje e të drejtës së tyre për jetën private (23/01/2024)**

Rasti i **O.G. dhe të tjerët kundër Greqisë** (kërkesat nr. 71555/12 dhe 48256/13) kishte të bënte me publikimin

me vendim të autoriteteve të brendshme, të të dhënave mjekësore në lidhje me prostitutat që ishin diagnostikuar si HIV-pozitiv dhe mbulimin mediatik të tyre. Rasti gjithashtu kishte të bënte me rrethanat në të cilat atyre iu kërkuar që t'i nënshtroheshin një analize të gjakut. Në aktgjykimin e Dhomës së saj në këtë rast, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut konstatoi, njëzëri, se kishte pasur dy shkelje: **shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në lidhje me dy parashtrues të kërkesës, për shkak të analizave të gjakut që u ishte kërkuar të bënin. Gjykata vlerësoi se mostrat e gjakut të vendosura ndaj dy parashtruesve të kërkesës përbënin ndërhyrje në jetën e tyre private dhe vlerësoi se kjo nuk ishte në përputhje me ligjin në kuptimin e nenit 8 të Konventës, duke pasur parasysh se dispozitat e ligjit të brendshëm në fjalë duhet të ishin të parashikueshme në lidhje me efektet e tyre për parashtruesit e kërkesës. Në veçanti, Gjykata vlerësoi se asnjë nga dispozitat e cituara nga Qeveria nuk kishte qenë në gjendje të justifikonte një ndërhyrje mjekësore, qoftë të kryer nga zyrtarë policor apo mjekësor, si ajo e vendosur ndaj parashtruesve të kërkesës në fjalë.

- **shkelje e nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private)** të Konventës Evropiane në lidhje me katër parashtrues të kërkesës, për shkak të publikimit të të dhënave në lidhje me ta. Gjykata vlerësoi se publikimi i të dhënave të katër parashtruesve të kërkesës ishte një ndërhyrje joproporcionale në të drejtën e tyre për respektimin e jetës private. Emrat dhe fotografitë e këtyre parashtruesve dhe informata se ata ishin HIV pozitiv, ishin shkarkuar në faqen e internetit të departamentit të policisë dhe transmetuar nga media, dhe prokurori nuk ishte përpjekur të përcaktonte nëse masa të tjera, përmes të cilave mund të sigurohej më pak ekspozim mediatik të parashtruesve të kërkesës, mund të ishin ndërmarrë në rastet e tyre. Në fund, Gjykata vendosi të hiqte nga lista e saj pjesë të kërkesave ku kishin të bënin me pesë parashtrues të kërkesës, katër prej të cilëve kishin vdekur. Ajo gjithashtu hodhi poshtë ankesat e disa parashtruesve të kërkesës si të paafatshme ose për mosshkrim të mjeteve juridike të brendshme.

### \* **Sanksioni i vendosur ndaj gjyqtarit për postimet në Facebook në lidhje me çështjet me interes publik cenoi lirinë e tij të shprehjes (20/02/2024)**

Në vendimin e Dhomës së saj në rastin **Danileț kundër Rumanisë** (kërkesa nr. 16915/21), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut konstatoi, me shumicë (katër vota kundër tri), se kishte pasur:



**shkelje të nenit 10 (liria e shprehjes)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut Rasti kishte të bënte me një sanksion disiplinor të vendosur ndaj një gjyqtari nga Komisioni Kombëtar i Shërbimit Gjyqësor dhe Ligjor për postimin e dy mesazheve në llogarinë e tij në Facebook. Gjykata konstatoi se gjykatat e brendshme kishin dështuar t'i kushtonin vëmendjen e duhur disa faktorëve të rëndësishëm, veçanërisht në lidhje me kontekstin më të gjerë në të cilin ishin bërë deklaratat e parashtruesit të kërkesës, pjesëmarrjen e tij në një debat mbi çështjet me interes publik, çështjen nëse gjykimet vlerësuese të shprehura kishin qenë mjaftueshëm të bazuara në fakte dhe, së fundi, efektit potencialisht të frikshëm të sanksionit. Përveç kësaj, ekzistenca e një sulmi ndaj dinjitetit dhe nderit të profesionit të gjyqtarit nuk ishte demonstruar mjaftueshëm. Në vendimet e tyre, gjykatat kombëtare nuk i kishin dhënë lirisë së shprehjes së parashtruesit të kërkesës peshën dhe rëndësinë që i takonte një lirie të tillë në dritën e praktikës gjyqësore të Gjykatës, edhe pse ishte përdorur një mjet komunikimi (përkatësisht një llogari në Facebook e qasshme nga publiku) që mund të ketë ngritur çështje legjitime në lidhje me respektimin e detyrës së vetëpërmbajtjes nga gjyqtarët. Rrjedhimisht, gjykatat rumune nuk kishin dhënë arsye relevante dhe të mjaftueshme për të justifikuar ndërhyrjen e pretenduar në të drejtën e parashtruesit të kërkesës për lirinë e shprehjes. Përveç kësaj, Gjykata konstatoi se neni 8 i Konventës nuk ishte i aplikueshëm në këtë rast dhe deklaroi, njëzëri, ankesën sipas atij neni të papranueshme.

**\* Shkarkimi i punonjësit të bankës për shkak të emailit ku kritikonte mangësitë e kompanisë cenoi lirinë e tij të shprehjes (20/02/2024)**

Në aktgjykimin e Dhomës së saj në rastin **Dede kundër Turqisë** (kërkesa nr. 48340/20), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut konstatoi, njëzëri, se kishte pasur: **shkelje të nenit 10 (liria e shprehjes)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti kishte të bënte me shkarkimin e një punonjësi të bankës për shkak se i kishte dërguar një email stafit të departamentit të burimeve njerëzore të kompanisë së tij duke kritikuar metodat e menaxhimit të një drejtuesi të lartë. Punëdhënësi konsideroi se emaili kishte shkaktuar shqetësim që kishte prishur qetësinë dhe rendin në vendin e punës. Gjykata konstatoi se gjykatat kombëtare – pranë të cilave parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur kërkesë për shkarkimin e padrejtë për arsye të lirisë së shprehjes – nuk kishin kryer një shqyrtim mjaftueshëm të detajuar të përmbajtjes së emailit në fjalë, në të cilin parashtruesi i kërkesës kishte kritikuar mangësitë e pretenduara në menaxhimin e kompanisë. Në veçanti, ata nuk ishin

përpjekur të përcaktonin nëse emaili i parashtruesit të kërkesës kishte krijuar bezdi në vendin e punës ose kishte pasur një ndikim negativ te punëdhënësi. Gjykata në lidhje me këtë vlerësoi se kritikrat e përfshira në emailin e parashtruesit të kërkesës ishin me interes për kompaninë në fjalë dhe se ato i ishin dërguar brenda një grupi të vogël pranuesish brenda kompanisë. Më tej, ajo vuri në dukje se gjykatat e brendshme kishin lënë në fuqi vendimin e punëdhënësit për të vendosur sanksionin më të rëndë ndaj punonjësit, pa marrë parasysh mundësinë e zbatimit të një dënimi më të lehtë. Ajo zbuloi se autoritetet kombëtare nuk kishin demonstruar bindshëm në arsyetimin e tyre se – duke refuzuar pretendimin e parashtruesit të kërkesës për largim të padrejtë nga puna – ishte vendosur një ekuilibër i drejtë midis lirisë së tij të shprehjes dhe të drejtës së punëdhënësit të tij për të mbrojtur interesat legjitime të kompanisë.

**\* Gjykata i deklaroi të papranueshme kërkesat e parashtruara kundër Portugalisë dhe 32 Shteteve të tjera për çështjen e ndryshimeve klimatike (09/04/2024)**

Në vendimin e saj në rastin **Duarte Agostinho dhe të tjerët kundër Portugalisë dhe 32 të tjerë** (kërkesa nr. 39371/20), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut njëzëri e deklaroi **kërkesën të papranueshme**. Parashtruesit e kërkesës, gjashtë shtetas të rinj portugez, u ankuan për ndikimet ekzistuese dhe serioze të ndryshimeve klimatike në të ardhmen. Ata parashtruan se Portugalia tashmë po përjetonte një sërë ndikimesh të ndryshimeve klimatike, duke përfshirë rritjen e temperaturave mesatare dhe nxehtësinë ekstreme, e cila ishte nxitës kryesor i zjarreve të pyjeve. Ata u mbështetën në nene të ndryshme të Konventës, instrumente ndërkombëtare si Marrëveshja e Parisit e vitit 2015 dhe Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve, dhe raporte të përgjithshme dhe gjetje ekspertësh në lidhje me dëmin e shkaktuar nga ndryshimet klimatike. Sipas mendimit të parashtruesve të kërkesës, Portugalia dhe 32 Shtetet e tjera të paditura mbanin përgjegjësi për situatën në fjalë. Ata parashtruan se aktualisht ishin të ekspozuar ndaj rrezikut të dëmtimit nga ndryshimet klimatike dhe se rreziku ishte përcaktuar të rritet ndjeshëm gjatë jetës së tyre. Ata argumentuan se brezi i tyre ishte veçanërisht i prekur nga ndryshimet klimatike dhe se, duke pasur parasysh moshën e tyre, ndërhyrja në të drejtat e tyre ishte më e theksuar se në rastin e gjeneratave të mëparshme. Për sa i përket juridiksionit ekstraterritorial të Shteteve të paditura, përveç Portugalisë, Gjykata konstatoi se nuk kishte arsye në Konventë për zgjerimin, përmes





interpretimit gjyqësor, të juridiksionit të tyre ekstraterritorial në mënyrën e kërkuar nga parashtruesit e kërkesës. Më pas u krijua juridiksioni territorial në lidhje me Portugalinë, ndërsa asnjë juridiksion nuk mund të vendosej në lidhje me Shtetet e tjera të paditura. Prandaj, ankesa e parashtruesve kundër Shteteve të tjera të paditura duhej të deklarohet e papranueshme në përputhje me nenin 35 paragrafët 3 dhe 4 të Konventës. Duke pasur parasysh faktin se parashtruesit e kërkesës nuk kishin ndjekur asnjë rrugë ligjore në Portugali në lidhje me ankesat e tyre, ankesa e parashtruesve kundër Portugalisë ishte gjithashtu e papranueshme për mosshterimin e mjeteve juridike të brendshme.

**\* Shkelje të shumta në rastin e ngritur nga Gjeorgjia kundër Rusisë në lidhje me shkeljen e të drejtave të njeriut të shkaktuar nga forcimi i vijave kufitare pas konfliktit të vitit 2008 (09/04/2024)**

Në aktgjykimin e Dhomës së saj në rastin **Gjeorgjia kundër Rusisë (IV)** (kërkesa nr. 39611/18), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut konstatoi, njëzëri, se kishte pasur: **shkelje të nenit 2 (e drejta për jetën), 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose poshtëruar), 5 paragrafi 1 (e drejta për liri dhe siguri) dhe 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare), nenet 1 (mbrojtja e pronës) dhe 2 (e drejta për arsimim) të Protokollit nr. 1 dhe neni 2 i Protokollit nr. 4 (liria e lëvizjes)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Konflikti i armatosur midis Gjeorgjisë dhe Rusisë në gusht 2008 çoi në një proces, i cili filloi në vitin 2009 dhe njihet si “kufitarizimi”, duke bllokuar njerëzit të kalojnë lirshëm vijat kufitare administrative midis territorit të kontrolluar nga Gjeorgjia dhe rajoneve separatiste gjeorgjiane të mbështetura nga Rusia të Abkhazisë dhe Osetisë së Jugut. Situata është cilësuar si “një nga trashëgimitë më të dhimbshme të konfliktit Gjeorgji-Rusi të gushtit 2008” 2. Qeveria gjeorgjiane pretendoi në veçanti se njerëzit ishin vrarë gjatë përpjekjes për të hyrë ose dalë nga Abkhazia ose Osetia e Jugut, ndërsa të tjerët ishin arrestuar, ndaluar dhe/ose keqtrajtuar për “kalim ilegal” të vijave kufitare administrative. Njerëzit ishin privuar nga toka, të cilën e përdornin për bujqësi, familjet ishin ndarë dhe fëmijët ishin detyruar të zgjidhnin midis mësimin në rusisht ose udhëtimeve të gjata dhe të rrezikshme në territorin e kontrolluar nga Gjeorgjia për të ndjekur shkollën. Gjykata konstatoi se kishte prova të mjaftueshme, në veçanti lista të viktimeve, dëshmi, raporte mediatike dhe materiale ndërkombëtare, për të konkluduar përtej dyshimit të arsyeshëm se incidentet e pretenduara nuk ishin të

izoluara dhe ishin mjaft të shumta dhe të ndërlidhura për të arritur në një model apo sistem shkeljesh. Për më tepër, mungesa e dukshme e një hetimi efektiv për incidentet dhe zbatimi i përgjithshëm i masave ndaj të gjithë personave në fjalë dëshmoi se praktika të tilla ishin toleruar zyrtarisht nga autoritetet ruse.

**\* Shkeljet e Konventës Evropiane për moszbatimin e masave të mjaftueshme për të luftuar ndryshimet klimatike (09/04/2024)**

Në aktgjykimin e Dhomës së Madhe në rastin **Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët kundër Zvicrës** (kërkesa nr. 53600/20), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut konstatoi, me një shumicë prej gjashtëmbëdhjetë votash kundër një, se kishte pasur: **shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; dhe, njëzëri, se ka pasur: shkelje të nenit 6 paragrafi 1 (qasja në gjykatë).

Rasti kishte të bënte me një ankesë nga katër gra dhe një shoqatë zvicerane, Verein KlimaSeniorinnen Schweiz, anëtarët e së cilës janë të gjitha gra të moshuara të shqetësuara për pasojat e ngrohjes globale në kushtet e jetesës dhe shëndetin e tyre. Ato konsiderojnë se autoritetet zvicerane nuk po ndërmarrin veprime të mjaftueshme, pavarësisht nga detyrat e tyre sipas Konventës, për të zbutur efektet e ndryshimeve klimatike. Gjykata konstatoi se neni 8 i Konventës përfshin të drejtën për mbrojtje efektive nga autoritetet shtetërore nga efektet serioze negative të ndryshimeve klimatike në jetë, shëndet, mirëqenie dhe cilësi të jetës. Megjithatë, ajo konstatoi se katër parashtrueset individuale nuk përmbushnin kriteret e statusit të viktimeve sipas nenit 34 të Konventës dhe i deklaroi ankesat e tyre të papranueshme. Shoqata parashtruese, për dallim, kishte të drejtën (locus standi) për të parashtruar ankesë në lidhje me kërcënimet që lindin nga ndryshimet klimatike në Shtetin e paditur në emër të atyre individëve që mund të pretendonin në mënyrë të argumentueshme se i nënshtrohen kërcënimeve specifike ose efekteve negative të ndryshimeve klimatike. mbi jetën, shëndetin, mirëqenien dhe cilësinë e jetës së tyre siç mbrohen nga Konventa. Gjykata konstatoi se Konfederata Zvicerane nuk kishte përmbushur detyrat e saj (“detyrimet pozitive”) sipas Konventës në lidhje me ndryshimet klimatike. Kishte pasur boshllëqe kritike në procesin e vendosjes së kornizës rregullatore përkatëse të brendshme, duke përfshirë dështimin e autoriteteve zvicerane për të përcaktuar sasinë, përmes buxhetit të karbonit ose ndryshe, kufizimeve kombëtare të emetimeve të gazeve serrë (GHG). Zvicra gjithashtu kishte dështuar të përmbushte objektivat e



saj të mëparshme për reduktimin e emetimeve të GS. Ndërsa pranoi se autoritetet kombëtare gëzojnë liri të gjerë në lidhje me zbatimin e legjislacionit dhe masave, Gjykata konstatoi, në bazë të materialit para saj, se autoritetet zvicerane nuk kishin vepruar në kohën dhe në mënyrën e duhur për të hartuar, zhvilluar dhe zbatuar legjislacionin dhe masat përkatëse në këtë rast. Përveç kësaj, Gjykata konstatoi se neni 6 paragrafi 1 i Konventës zbatohet për ankesën e shoqatës parashtruese në lidhje me zbatimin efektiv të masave zbutëse sipas ligjit ekzistues të brendshëm. Gjykata konstatoi se gjykatat zvicerane nuk kishin dhënë arsye bindëse se pse e kishin konsideruar të panevojshme shqyrtimin e meritave të ankesave së shoqatës parashtruese. Ato nuk kishin marrë parasysh provat bindëse shkencore në lidhje me ndryshimet klimatike dhe nuk i kishin marrë seriozisht ankesat.

**\* Gjykata Evropiane refuzon si të papranueshme ankesën e këngëtarit të famshëm rus për ndalimin e hyrjes në Lituani (18/04/2024)**

Në vendimin e saj në rastin **Kirkorov kundër Lituanië** (kërkesa nr. 12174/22) Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut me shumicë deklaroi kërkesën të papranueshme. Rasti kishte të bënte me ndalimin e parashtruesit të kërkesës, një këngëtar dhe producent i njohur muzikor në Rusi, për të hyrë në Lituani, sepse ai konsiderohej një kërcënim për sigurinë kombëtare. Autoritetet lituaneze zbuluan veçanërisht se ai ishte një mjet për propagandën e Rosisë në shtetet e ish-BRSS-së dhe se, duke dhënë rregullisht koncerte në Krime, ai mbështeti politikën e agresionit të shtetit rus. Në përgjithësi, Gjykata konstatoi se vlerësimi i autoriteteve lituaneze, i cili ishte bazuar në deklaratat dhe sjelljen e parashtruesit të kërkesës, nuk kishte qenë arbitrar ose pa bazë. Në veçanti, parashtruesi kishte deklaruar hapur se ai mbështeste veprimet e Rosisë në gadishullin e Krimesë dhe i referohej vetes si “përfaqësuesi në skenë” i Vladimir Putinit. Për më tepër, gjykatat kishin peshuar interesat e sigurisë kombëtare dhe rendit publik kundrejt veprimeve të parashtruesit të kërkesës dhe ndalimit të vendosur ndaj tij dhe nuk e gjetën atë të ketë qenë në disproporcion. Gjykata gjithashtu theksoi se gjykatat kombëtare, Seimas (Parlamenti Lituanez) dhe Parlamenti Evropian e kishin pranuar të gjithë nevojën për ekspozimin e dezinformatave ruse dhe të luftës propagandistike.

**\* Arrestimi dhe paraburgimi i gjyqtarit të OKB-së pavarësisht imunitetit të tij diplomatik, në mesin e tentativës për grusht shtet ushtarak të vitit 2016 në Turqi (23/04/2024)**

Në aktgjykimin e Dhomës së saj në rastin Aydın Sefa Akay kundër Turqisë (kërkesa nr. 59/17), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut konstatoi, njëzëri, se kishte pasur: shkelje të nenit 5 paragrafi 1 (e drejta për liri dhe siguri) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës Evropiane. Rasti kishte të bënte me arrestimin dhe paraburgimin e një gjyqtari të OKB-së, si dhe kontrollin e shtëpisë dhe personit të tij, pas tentativës për grusht shtet ushtarak të vitit 2016 në Turqi, pavarësisht nga imuniteti i tij diplomatik. Ai ishte duke punuar në distancë nga shtëpia e tij në Stamboll për Mekanizmin Ndërkombëtar Residual të Kombeve të Bashkuara për Tribunale Penale (“Mekanizmi i Tribunaleve Penale të OKB-së”) kur u arrestua.

Gjykata nuk ishte e kënaqur me interpretimin e të drejtës ndërkombëtare nga gjykatat kombëtare kur refuzoi kërkesën e tij për imunitet diplomatik. Ajo zbuloi gjithashtu se z. Akay duket se kishte të drejtën e imunitetit të plotë diplomatik, duke përfshirë paprekshmërinë e personit dhe të banesës së tij private, si dhe të mbrojtur nga çdo formë arrestimi ose ndalimi, sipas ligjit ndërkombëtar. Arrestimi i tij, paraburgimi, kontrolli i shtëpisë dhe personit të tij kishte qenë kështu i paligjshëm. Për më tepër, gjykatat kishin shqyrtuar fillimisht çështjen e imunitetit diplomatik të parashtruesit të kërkesës pas më shumë se tetë muaj, duke e bërë të padobishme çdo mbrojtje që kishte pasur zoti Akay si gjyqtar ndërkombëtar dhe nuk e kishin shqyrtuar fare atë në lidhje me kontrollin e shtëpisë dhe personit të tij.

**\* Rregulli i fshehtësisë lidhur me informatat rreth birësimit ka shkelur Konventën (14/05/2024)**

Në aktgjykimin e Dhomës në rastin **Mitrevska kundër Maqedonisë së Veriut** (kërkesa nr. 20949/21), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, njëzëri konstatoi se ka pasur: **shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti kishte të bënte me qasjen në informata në lidhje me një birësim. Znj. Mitrevska, e cila ishte birësuar si fëmijë, donte të dinte më shumë për familjen e saj biologjike, duke përfshirë historinë e tyre mjekësore. Gjykata pranoi ndjeshmërinë e çështjes në fjalë dhe nuk e nënvlerësoi ndikimin që mund të kishte zbulimi i informatave për një birësim tek të gjithë ata të interesuar. Megjithatë, ajo zbuloi se autoritetet kishin refuzuar kërkesën e znj. Mitrevska për informata rreth origjinës së saj duke u mbështetur thjesht në ligjin përkatës kombëtar, i cili i kategorizon të gjitha birësimet si “sekret zyrtar”, pa balancuar interesat





konkurruese në fjalë. Ky ushtrim balancues duhet të kishte përfshirë peshimin e interesit të fëmijës së birësuar për të njohur informata me rëndësi qendrore për jetën e tij/saj personale kundrejt interesit të përgjithshëm, përkatësisht pritshmërisë së nënave biologjike që informatat rreth tyre të mos zbulohen.

**\* Ekuilibri i drejtë nuk është arritur nga Gjykata Supreme e Republikës së Moldavisë në rastin lidhur me lirinë e shprehjes dhe të drejtën e një figure publike për reputacion (14/05/2024)**

Në aktgjykimin e Dhomës së saj në rastin **Oleg Balan kundër Republikës së Moldavisë** (kërkesa nr. 25259/20), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut konstatoi, njëzëri, se ka pasur: **shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Rasti kishte të bënte me publikimin e një dokumenti nga z. Usatii, lideri i një partie opozitare, në faqen e tij në Facebook, për të cilin ai pretendonte se ishte shkruar nga Shërbimi Moldav i Sigurisë dhe Informacionit dhe i ishte drejtuar Presidentit. Dokumenti akuzonte z. Balan, Ministër i Brendshëm në atë kohë, për veprimtari kriminale. Megjithëse Shërbimi i Sigurisë dhe Informacionit deklaroi publikisht se nuk kishte dërguar kurrë një dokument të tillë dhe Zyra e Presidentit konfirmoi se nuk e kishte marrë atë, Gjykata Supreme refuzoi pretendimet e z. Balan kundër z. Usatii, duke konstatuar se lideri i partisë opozitare kishte të drejtën e mbrojtjes së lirisë së shprehjes, edhe sipas ligjit kombëtar, po ashtu edhe sipas Konventës. Gjykata vlerësoi se Gjykata Supreme kishte vendosur të aplikojë prezumimin e mirëbesimit të zbatueshëm për gazetarët hulumtues. Ajo kishte dështuar të kryente analizën e saj të kujdesshme të elementeve të shkresave të lëndës në lidhje me mbrojtjen e të drejtës së z. Balan për reputacion. Prandaj, Gjykata nuk ishte e bindur se Gjykata Supreme kishte arritur një ekuilibër të drejtë midis të drejtave konkurruese të përfshira në Konventën Evropiane.

**\* Ligji italian duhet të parashikojë shqyrtimin gjyqësor të masave të përgjimit të telefonave që prekin individë që nuk janë palë në procedurën penale (23/05/2024)**

Në aktgjykimin e Dhomës në rastin Contrada kundër Italisë (nr. 4) (kërkesa nr. 2507/19), i cili kishte të bënte me ligjshmërinë e përgjimit të bisedave telefonike të parashtruesit të kërkesës dhe bastisjen e shtëpisë së tij dhe pronave të tjera (masat e

urdhëruara në kontekstin e procedurave të vrasjes në të cilat parashtruesi i kërkesës nuk ishte i përfshirë drejtpërdrejt), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut arriti në përfundimet e mëposhtme. Me shumicë, Gjykata e shpalli ankesën e parashtruesit në lidhje me bastisjen e shtëpisë së tij të papranueshme për mosshkrim të mjeteve juridike të brendshme. Ajo vlerësoi se parashtruesi i kërkesës nuk kishte aplikuar për shqyrtimin e masës nga gjykatat e brendshme – siç parashihet me nenet 257 dhe 324 të Kodit të Procedurës Penale – para se ta parashtronte kërkesën e tij në Gjykatë. Njëzëri, Gjykata konstatoi se kishte pasur shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në lidhje me përgjimin dhe transkriptimin e komunikimeve telefonike të parashtruesit të kërkesës. Ajo konstatoi se ligji italian nuk ofronte garanci adekuate dhe efektive kundër abuzimit të individëve që i ishin nënshtruar një mase përgjimi, por që, duke qenë se nuk ishin të dyshuar ose të akuzuar për përfshirje në një vepër, nuk ishin palë në procedurë. Në veçanti, këta individë nuk ishin në gjendje të aplikonin pranë një autoriteti gjyqësor për një shqyrtim efektiv të ligjshmërisë dhe domosdoshmërisë së masës dhe për të marrë dëmshpërblimin e duhur, sipas rastit.

**\* Mungesa e paanshmërisë së gjykatës së brendshme cenonte të drejtat e gazetarit të dënuar për shpifje (04/06/2024)**

Rasti **Bosev kundër Bullgarisë** (kërkesa nr. 62199/19) kishte të bënte me dënimin e një gazetari për shpifje ndaj një zyrtari të lartë të qeverisë dhe, më konkretisht, dyshimet në lidhje me paanshmërinë e njërit prej gjyqtarëve që kishte vendosur për akuzat e ngritura kundër tij në procedurën e apelit. Në aktgjykimin e Dhomës në këtë rast, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut konstatoi, njëzëri, se kishte pasur dy shkelje të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkatësisht:

- **shkelje të nenit 6 para. 1 (e drejta për një proces të rregullt) të Konventës**, dhe

- **shkelje të nenit 10 (liria e shprehjes) të Konventës**.

Gjykata vërejtë se disa vite përpara rastit në fjalë, z. Bosev, në cilësinë e tij si gazetar, kishte shkruar dhe botuar artikuj në të cilët kishte vënë në pikëpyetje profesionalizmin dhe integritetin e një gjyqtari i cili ishte anëtar i trupit gjykues që më pas kishte vendosur për dënimin e tij në procedurën e apelit. Ajo mbajti qëndrimin se z. Bosev mund të kishte pasur dyshime objektive dhe të arsyeshme lidhur me paanshmërinë e gjyqtarit në fjalë, të cilit ai i kishte kërkuar të tërhiqej



nga rasti. Megjithatë, kërkesa e tij ishte hedhur poshtë gjithnjë nga trupi gjykues në të cilin ishte gjyqtari në fjalë dhe vendimi i ishte diktuar nëpunësit nga vetë ajo gjyqtare gjatë seancës. Gjykata vëren, në fund, se nuk ka pasur asnjë ankesë për çështje ligjore kundër dënimit të dhënë në procedurën e apelit. Rrjedhimisht, Gjykata konstatoi se gjykata e apelit nuk përbënte një “gjykatë të paanshme” dhe se mënyra në të cilën ishte vendosur sanksioni ndaj z. Bosev në rastin në fjalë nuk kishte arritur të siguronte një nga garancitë thelbësore të një gjykimi të drejtë. Më tej, ajo konstatoi se kufizimi i të drejtës së parashtruesit të kërkesës për lirinë e shprehjes nuk ishte shoqëruar me masa mbrojtëse efektive dhe adekuate kundër arbitraritetit.

**\* Vendimi për shkarkimin e deputetit nga detyra për shkak të konfliktit të interesit nuk ishte arbitrar apo qartazi i paarsyeshëm (11/06/2024)**

Në aktgjykimin e Dhomës së saj në rastin Kokëdhima kundër Shqipërisë (kërkesa nr. 55159/16), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut vendosi, njëzëri, se nuk kishte pasur: **shkelje të nenit 3 të Protokollit nr. 1 (e drejta për zgjedhje të lira)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Rasti kishte të bënte me vendimin për shkarkimin e z. Kokëdhima nga detyra si deputet për shkak të konfliktit të interesit lidhur me pronësinë e tij mbi një kompani që merrte të ardhura nga burime publike. Gjykata Kushtetuese e vuri në dyshim faktin se z. Kokëdhima kishte shitur aksionet e kompanisë së tij vetëm pas më shumë se gjashtë muaj pas zgjedhjes së tij. Gjykata nuk mund të gjente ndonjë gjë arbitrare ose qartazi të paarsyeshme në këtë qasje. Për më tepër, z. Kokëdhima duhej të kishte pasur dijeni për ligjet dhe praktikën e zbatueshme në rastin e tij dhe për këtë arsye mund të kishte parashikuar që vazhdimi i përfitimit të të ardhurave të krijuara nga kontratat me autoritetet publike në rolin e tij të ri si deputet do të përbënte një konflikt interesi.

**\* Shkelje të shumta në rastin e ngritur nga Ukraina kundër Ruisë në lidhje me Krimenë (25/06/2024)**

Rasti i **Ukrainës kundër Ruisë (re Crimea)** (kërkesat nr. 20958/14 dhe 38334/18) kishte të bënte me pretendimet e Ukrainës lidhur me një model (“praktikës administrative”) të shkeljeve të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut nga Federata Ruse në Krime që kishte filluar në shkurt të vitit 2014. Rasti gjithashtu kishte të bënte me pretendimet për një model persekutimi të ukrainasve për qëndrimin e tyre politik dhe/ose aktivitetin pro-ukrainas (“të burgosurit

politikë ukrainas”) që kishin ndodhur kryesisht në Krime, por edhe në pjesë të tjera të Ukrainës ose në Federatën Ruse që nga fillimi i vitit 2014. Qeveria ukrainase pretendoi se këto shkelje të të drejtave të njeriut kishin qenë pjesë e një fushate represioni, e cila përfshinte në veçanti zhdukje; keqtrajtim; ndalim të paligjshëm; pamundësi për të hequr dorë nga shtetësia ruse; shtypja e mediave ukrainase dhe e gjuhës ukrainase në shkolla; paraburgimi në kushte të mbipopulluara; ndjekja penale dhe dënimi për akuza të fabrikuara pa një gjykim të drejtë si hakmarrje për çdo qëndrim pro-ukrainas; dhe, transferime nga Krimea në burgjet në Rusi. Në aktgjykimin e saj të Dhomës së Madhe në këtë rast, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut konstatoi, njëzëri, se kishte pasur: shkelje të neneve 2 (e drejta për jetën), 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës), 5 (e drejta për liri dhe siguri), 6 (e drejta për një proces të rregullt), 7 (nuk ka dënim pa ligj), 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare), 9 (liria e fesë), 10 (liria e shprehjes), 11 (liria e tubimit), 14 (ndalimi i diskriminimit) dhe 18 (Kufiri i zbatueshmërisë së kufizimeve të të drejtave) të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut, dhe neni 1 i protokollit nr. 1 (mbrojtja e pronës), neni 2 i protokollit nr. 1 (e drejta për arsimim) dhe neni 2 i protokollit nr. 4 (liria e lëvizjes) të Konventës Evropiane.

Ajo gjithashtu konstatoi, njëzëri, se Federata Ruse nuk kishte përmbytur detyrimet e saj sipas nenit 38 (detyrimi për të ofruar lehtësitë e nevojshme për shqyrtimin e çështjes) të Konventës. Në fund, Gjykata konstatoi, njëzëri, në bazë të nenit 46 (forca detyruese dhe ekzekutimi i vendimeve), se Rusia duhej të merrte masa sa më shpejt të ishte e mundur për kthimin e sigurt të të burgosurve përkatës të transferuar nga Krimea në objektet penale të vendosura në territorin e Federatës Ruse.

Gjykata konsideroi se kishte prova të mjaftueshme – në veçanti raportet e organizatave ndërqeveritare dhe joqeveritare, të vërtetuara nga dëshmitë e dëshmitarëve dhe materiale të tjera – për të konkluduar përtej dyshimit të arsyeshëm se incidentet kishin qenë mjaft të shumta dhe të ndërlydhura për të arritur në një model apo sistem shkeljesh. Për më tepër, mungesa e dukshme e një hetimi efektiv lidhur me incidentet dhe/ose zbatimin e përgjithshëm i masave ndaj të gjithë personave në fjalë, ndër të tjera, dëshmoi se praktika të tilla ishin toleruar zyrtarisht nga autoritetet ruse. Ajo theksoi se praktika të tilla kishin ndodhur në kontekstin e zbatimit të plotë të ligjit rus në Krime. Kjo situatë ishte në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare humanitare (DNH), e cila





parashikonte se ekzistonte një detyrim për të respektuar ligjet tashmë në fuqi në territorin e pushtuar, që në këtë rast do të kishte qenë ligji para-ekzistues ukrainas. Duke konfirmuar se DNH duhej të merrej parasysh në vlerësimin e rastit, ajo gjeti se Rusia e kishte shtrirë zbatimin e ligjit të saj në Krime në kundërshtim me Konventën. Në fund, ajo konstatoi se kishte pasur një model të ndjekjes hakmarrëse dhe keqpërdorimit të ligjit penal dhe një goditje të përgjithshme të opozitës politike ndaj politikave ruse në Krime, e cila ishte zhvilluar dhe promovuar publikisht nga përfaqësues të shquar të autoriteteve ruse.

*(Për më shumë hollësi vizitoni faqen e internetit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut: [www.echr.coe.int](http://www.echr.coe.int))*

# INFORMATATA PËR GJYKATËN

---

## Ndërtesa e Gjykatës Kushtetuese:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, që nga funksionalizimi i saj më 2009, është e vendosur në ish-objektin e Trupave Mbrojtëse të Kosovës, që ndodhet në qendër të Prishtinës, në lagjen “Pejton”. Ky lokacion i Gjykatës, në qendër të kryeqytetit, është simbol i qasjes së barabartë të të gjithë qytetarëve dhe të palëve të tjera të autorizuara në drejtësinë kushtetuese. Ky objekt ndër vite është përshtatur për nevojat dhe për natyrën e punës së Gjykatës Kushtetuese. Kjo është bërë me ndihmën e donatorëve, siç është rasti me ndërtimin e sallës së gjykimeve, që është financuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Turqisë në vitin 2010, themelimin e Bibliotekës së Gjykatës, e cila u mbështet në tërësi nga projekti i GIZ-it për Reformë Ligjore, si dhe sigurimi i zyrave shtesë (kontejnerë), donacion nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Turqisë në vitin 2011.

Objekti i Gjykatës ka gjithsej 1 937 m<sup>2</sup> hapësirë të shfrytëzueshme për punë, që shfrytëzohet nga 65 punonjës.



## ADRESA

Rruga: “Perandori Justinian”, nr. 44, 10 000 - Prishtinë

Tel: +383 (0)38 60 61 62

Mob: +383 (0)45 200 595; +383 (0)45 200 576

Fax: +383 (0)38 60 61 70

E-mail: [gjykata.kushtetuese@gjk-ks.org](mailto:gjykata.kushtetuese@gjk-ks.org)

Ueb: [www.gjk-ks.org](http://www.gjk-ks.org)